




HARUN JAHJA

MREKULLI NË TRUPIN TONË



DY FJALË RRETH AUTORIT



I njohur me emrin HARUN JAHJA, Adnan Oktar, u lind në Ankara në vitin 1956. Pasi kreu studimet fillore dhe të mesme në Ankara, ai studioi për arte në Universitetin Mimar Sinan në Stamboll dhe filozofi në universitetin e Stambollit. Që nga viti 1980, ai ka botuar mjaft libra në lidhje me çështje politike, shkencore, dhe fetare. Duke qenë mjaft të vlerësuara në të gjithë botën, këto vepra kanë shërbyer për shumë njerëz si mjet për të gjetur besimin në Zot dhe për të arritur një njohje më të thellë për besimin e tyre. Librat e Harun Jahjasë u drejtohen të gjithë lexuesve, pa marrë parasysh moshën, racën, apo kombësinë e tyre, sepse ata përqendrohen në një synim: të hapin horizontin e lexuesit duke e nxitur atë të mendojë për disa çështje të rëndësishme, si qenia e Allahut dhe Njëshmëria e Tij dhe të jetuarit sipas vlerave që Ai ka përcaktuar për ne.



Secila nga trilionat e qelizave të trupit tonë e përmbush detyrën e saj në mënyrë të përsosur, si rezultat i një plani të përkryer të Allahut, në mënyrë që ne të vazhdojmë jetën tonë pa asnjë vështirësi. Të zgjuarit çdo mëngjes për të shkuar në shkollë, të shijuarit e shijes së këndshme të mjalitit, frymëmarrja pa asnjë vështirësi, të vrapuarit dhe luajtja me shokët në oborrin e shkollës, të shkruarit, të lexuarit dhe mjaft gjëra të tjera që ju bëni janë vetëm në sajë të dashurisë, dhembshurisë dhe mëshirës së Allahut. Ashtu si çdo gjë tjetër mbi tokë, Allahu ju ka krijuar në mënyrë të përsosur dhe ju ka dhënë çdo gjë që ju keni nevojë. Ajo çfarë ju mbetet të bëni është që ta falënderoni Zotin tonë, i Cili ju ka dhënë gjithë këto mirësi, të cilat janë dhurata më e vyer se çdo dhuratë tjetër që mund t'ju jepet në këtë botë. Në këtë libër, ne do të mendojmë rreth trupit tonë. Do të shohim se, sa përsosmërisht dhe të ndërlikuar e ka krijuar Allahu trupin i njeriut. Pasi të keni lexuar librin, ju do ta doni akoma më shumë Allahun dhe do ta falënderoni Atë. Po ashtu, do të çuditeni me moskokëçarjen e madhe të njerëzve që ju rrethojnë, të cilët nuk mendojnë dhe nuk meditojnë, dhe do të jeni të etur për t'u treguar atyre çfarë keni mësuar, në mënyrë që edhe ata të jenë më të vëmendshëm ndaj këtyre mirësive.




Shtëpia Botuese "Furkan ISM"

Brigada II Maqedonase, lokali 22 1000 Shkup, Maqedoni

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

اللَّهُ
رَسُولُ
مُحَمَّدٍ



MREKULLI NË TRUPIN TONË



Dy fjalë rreth autorit dhe veprave të tij

I njohur me emrin HARUN JAHJA, Adnan Oktar, u lind në Ankara në vitin 1956. Pasi kreu studimet fillore dhe të mesme në Ankara, ai studioi për arte në Universitetin Mimar Sinan në Stamboll dhe filozofi në universitetin e Stambollit. Që nga viti 1980, ai ka botuar mjaft libra në lidhje me çështje politike, shkencore, dhe fetare. Harun Jahja është njohur mirë si autor i veprave të rëndësishme, të cilat zbulojnë mashtrimin e evolucionistëve, pohimet e tyre të pavërteta dhe lidhjet e errëta midis Darwinizmit dhe ideologjive gjakësore, të tilla si: fashizmi dhe komunizmi.

Veprat e Harun Jahjasë, të përkthyer në 57 gjuhë të ndryshme, përbëjnë një koleksion prej mëse 45,000 faqesh me 30,000 ilustrime. Pseudonimi i tij është një ndërthurje e emrave të Harunit (Aaron) dhe Jahja (John), në kujtim të dy Profetëve të nderuar, të cilët luftuan kundër mohimit të besimit. Vula e Profetit në librat e tij është një simbol i cili është i lidhur me përmbajtjen e tyre. Ky simbol paraqet Kur'anin (Shpalljen e Fundit) dhe Profetin Muhamed (paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të), Profetin e fundit. Nën dritën e udhëzimit të Kur'anit dhe Sunnetit (traditës dhe mësimëve të Profetit), autori i ve vetes si qëllim të hedhë poshtë çdo ngrehinë të ideologjive që mohojnë fenë dhe të thotë "fjalën e fundit" në mënyrë që ta bëjë të heshtë çdo kundërshtim ngritur kundër fesë. Ai e përdor vulën e Profetit të fundit (paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të), i cili arriti urtësinë më të lartë dhe përsosmërinë morale, si një shenjë të qëllimit të tij për të ofruar fjalën e fundit.

Të gjitha veprat e Harun Jahja kanë një qëllim të përbashkët: të japin mesazhin e Kur'anit, të inkurajojnë lexuesit për të menduar mbi çështje që kanë të bëjnë me besimin, si për shembull, ekzistenca e Allahut dhe njëshmëria e Tij dhe besimi në Botën Tjetër dhe njëkohësisht të nxjerrë në pah rrënjët e kalbura të sistemeve antifetare dhe ideologjive të devijuara.

Harun Jahja gëzon një rang të gjerë lexuesish në shumë vende të botës, që nga India në Amerikë, nga Anglia në Indonezi, Poloni, e deri në Bosnjë, Spanjë, Brazil, Malajzi, Itali, Francë, Bullgari, e deri në Rusi. Disa nga librat e tij mund të gjenden në gjuhën Angleze, Frënge, Gjermane, Spanjolle, Italiane, Portugeze, Urdu, Arabe, Shqipe, Kineze, Dhivehi (folur në ishujt Mauritius) Ruse, Serbo-Croate



(Boshnjake), Polake, Malaje, Turke, Uygur, Indoneziane, Bengali, Daneze dhe Suedeze.

Duke qënë mjaft të vlerësuar në të gjithë botën, këto vepra kanë shërbyer për shumë njerëz si mjet për të gjetur besimin në Zot dhe për të arritur një depërtim më të thellë në besimin e tyre. Mençuria dhe sinqeriteti që i karakterizon librat e tij, së bashku me një stil të veçantë që është i lehtë për t'u kuptuar, ndikon drejtpërdrejt çdokënd që i lexon. Ata që i studiojnë me kujdes këta libra, nuk mund të mbrojnë më ateizmin apo ndonjë ideologji tjetër të devijuar apo filozofi materialiste, sepse këta libra karakterizohen nga një ndikim i shpejtë, përfundime të qarta dhe janë të pakundërshtueshëm. Edhe nëse këta njerëz do të vazhdojnë të këmbëngulin në të tyren, nuk do të jetë gjë tjetër veçse një këmbëngulje të kotë, sepse këta libra përmbysin ideologji të tilla që nga themelet. Të gjitha lëvizjet bashkëkohore antifetare tashmë mbrohen ideologjikisht, falë librave të shkruar nga Harun Jahja.

Kjo është, pa dyshim, një rezultat i urtësisë dhe dritës së Kur'anit. Autori në mënyrë modeste dëshiron të shërbejë si një mjet në kërkimin njerëzor të rrugës së drejtë të Allahut. Prej botimit të këtyre materialeve nuk kërkohet asnjë përfitim material.

Ata njerëz që inkurajojnë të tjerët për të lexuar këto libra, për të hapur mendjet dhe zemrat e tyre dhe për t'i udhëzuar ata të bëhen robër të devotshëm të Allahut, kryejnë një shërbim të paçmuar.

Njëkohësisht, do të ishte një humbje kohe dhe energjie për të reklamua libra të tjerë, të cilët krijojnë çoroditje në mendjet e njerëzve, i shpien ata në kaos ideologjik dhe që nuk kanë një ndikim të fortë dhe preciz në largimin e dyshimit prej mendjeve të njerëzve, siç është vërtetuar nga përvoja e përparshme. Për librat që janë shkruar vetëm e vetëm për të nxjerrë në pah fuqinë letrare të shkrimtarit se sa qëllimin fisnik për t'i shpëtuar njerëzit nga mungesa e besimit është e pamundur që të kenë një ndikim kaq të madh. Ata që e venë në dyshim këtë mund të shohin qartë se qëllimi i vetëm i librave të Harun Jahjasë është të mposhtë mosbesimin dhe, njëkohësisht, të përhapë vlerat morale të Kur'anit. Suksesi dhe ndikimi i këtij shërbimi shfaqen qartë në bindjen e lexuesve.

Një gjë duhet të mbahet parasysh: Arsyeya kryesore për vazhdimin e mizorisë, konflikteve dhe telasheve të tjera që po përjetojnë shumica e njerëzve sot është mbizotërimi ideologjik i mosbesimit. Kësaj mund t'i jepet fund vetëm me mposhtjen ideologjike të tij dhe, njëkohësisht, duke transmetuar mrekullitë e krijimit dhe moralin e Kur'anit, në mënyrë që njerëzit të jetojnë sipas tij. Duke patur parasysh gjendjen e botës sot, që po precipiton në një spirale dhune, korrupsioni dhe lufte, është e qartë se ky shërbim duhet të jepet shpejt dhe në mënyrë të suksesshme, përndryshe, do të jetë tepër vonë.

Në këtë drejtim, librat e Harun Jahjasë marrin një rol udhëheqës. Me lejen e Allahut, këto libra do të jenë një mjet, nëpërmjet të cilit njerëzit në shekullin e XXI do të gjejnë paqen, drejtësinë, dhe lumturinë e premtuar në Kur'an.

Të dashur fëmijë

o Të gjithë librat e Harun Jahjasë shpjegojnë tema që kanë lidhje me besimin nën dritën e vargjeve kuranore dhe i ftojnë lexuesit të mësojnë fjalët e Allahut dhe të jetojnë në përputhje me to. Të gjitha çështjet në lidhje me ajetet kuranore janë shpjeguar në mënyrë që të mos lihet vend për dyshim apo për pyetje në mendjen e lexuesit. Stili i thjeshtë dhe i rrjedhshëm i librave bën të mundur që çdo njeri i çfarëdo moshe qoftë dhe i çfarëdo grupi shoqëror t'i kuptojë ata me lehtësi. Falë shpalosjes së tyre të efektshme dhe të ndritshme, ata mund të lexohen me një frymë. Madje, edhe ata njerëz që e refuzojnë besimin ndikohen nga faktet që dokumentojnë këta libra dhe nuk mund të hedhin poshtë vërtetësinë e përmbajtjes së tyre.

o Ky libër, po ashtu, të gjithë librat e Harun Jahja mund të lexohen vetëm ose të diskutohen në grup. Lexuesit e etur për të përfutur nga librat do të zbulojnë se diskutimi është mjaft i dobishëm dhe u mundëson atyre të shkëmbejnë mendimet dhe përvojën e tyre me të tjerët.

o Një shërbim i madh për Islamin do të ishte ndihma në botimin dhe leximin e këtyre librave shkruar vetëm për hir të Allahut. Të gjithë librat e Harun Jahjasë janë jashtëzakonisht bindës. Për këtë arsye, për t'ia komunikuar të tjerëve fenë e vërtetë, një nga mënyrat më të dobishme do të ishte nxitja për të lexuar këta libra.

o Shpresojmë se, lexuesi do t'i hedhë një sy përmbledhjeve të librave të tjerë të autorit, të cilat janë vendosur në pjesën e pasme të këtij libri. Lënda e tij e pasur në çështjet e besimit është mjaft e dobishme dhe të sjell kënaqësi në lexim.

o Në këta libra, ndryshe nga librat e tjerë, janë mënjanuar tërësisht pikëpamjet personale të autorit, shpjegimet e bazuara në burime të dyshimta, stile që nuk i kushtojnë kujdesin e duhur temave fetare, dhe as argumenta të pashpresë apo pesimistë, të cilët krijojnë dyshime në mendjen e lexuesit dhe devijime në zemrat e tyre.

MREKULLI NË TRUPIN TONË



HARUN JAHJA



PËRMBAJTJA



* HYRJE.....	10
* NJË FABRIKË GIIGANDE QË NUK MUND.....	
TË SHIHET ME SY TË LIRË: QELISA	18
* NJË BILLET GIIGAND QË PËRSHKON.....	
TRUPIN TONË.....	24
* UDHËTIMI QË BËN UDHQIMI NË.....	
* TRUPIN TONË.....	34
* UDHËTIMI I GJAKUT NËPËR VENA.....	50

66.....SKELETI I PËRBËRË NGA KOCKAT *

MOTORËT MIKROSKOPIKË *

84.....TË TRUPIT: MËSKUJT

KONDITIONERI I AJRIT PUNON *

92.....PA PUSHIM NË TRUPIN TONË

102.....PËRFUNDIM *

HYRJJE


T

ë dashur fëmijë!

Përgatituni të futeni në një botë të gjerë dhe të mrekullueshme. Me të vërtetë, kjo botë është shumë tërheqëse për ju. Megjithëse, deri tani, ju ndoshta nuk keni qenë të vetëdijshëm, por trilionat punëtorë të kësaj bote kanë qenë duke punuar në mënyrë të vazhdueshme për ju. Po habiteni?

Kjo botë e mrekullueshme është trupi juaj dhe punëtorët që kanë qenë duke punuar për ju janë qelizat e trupit tuaj. Çdo pjesë, sado e vogël, e trupit tuaj është e përbërë nga qeliza. Edhe në këtë moment që ne flasim, trilionat qeliza në trupin tuaj janë në shërbimin tuaj.

Madje, ato janë duke punuar për ju edhe tani, kur ju jeni duke lexuar këtë libër. Për shembull, qelizat e syrit tuaj janë duke kryer një numër të madh procesesh në mënyrë



Trupi ynë përbëhet nga qelizat, ku secila nga to ka një detyrë të caktuar. Figura më sipër tregon disa lloje qelizash, të cilat bashkëveprojnë me njëra-tjetrën për të na bërë të mundur jetën.

të vazhdueshme për t'ju bërë të mundur të lexoni këtë libër. Kur merrni frymë, hyjnë në veprim qelizat e laringut dhe të mushkërive tuaja. Në të njëjtën kohë, qelizat e stomakut janë duke tretur ushqimin që ndoshta keni ngrënë pak orë më parë.

Ato që përmendëm këtu janë vetëm pak nga proceset që kryhen në mënyrë të pandërprerë, në trupin tuaj. Madje, të gjitha këto ndodhin duke qenë fare të pavetëdijsëm. Por, si është e mundur që trilionat qeliza të marra së bashku, të dinë çfarë duhet të bëjnë dhe të bashkëpunojnë me njëra





Dhe ja, qelizat tona mund të shihen me mikroskop



qelizat e syrit



qelizat nervore



rruazat e kuqe te gjakut



- tjetrën për të punuar? Për më
- tepër, gjatë këtyre proceseve nuk
- del asnjë pengesë. Asnjë nga
- qelizat nuk përpiqet të bëjë
- detyrën e një qelize tjetër apo të
- refuzojë të kryejë detyrën e saj.
- Veç kësaj, gjithë këta procese
- kryhen me një shpejtësi të
- jashtëzakonshme.

- Në faqet që vijojnë, ne do të
- shqyrtojmë se, si veprimet e
- përditshme, si tretja e ushqimit,
- frymëmarrja, të parit dhe dëgjimi
- janë, në jetën reale me të vërtetë
- mahnitëse. Ne do të dëshmojmë
- që qelizat tona ndonjëherë sillen
- si kimistë që prodhojnë substanca
- kimike, ndonjëherë sillen si
- inxhinierë që bëjnë llogaritje dhe
- ndonjëherë punojnë për të
- plotësuar nevojat e qelizave të
- tjera.



Është befasues fakti që, të gjitha këto qeliza janë shumë të vogla për t'u parë me sy të lirë. Për më tepër, qelizat e trupit tonë i kryejnë këto detyra jetësore pa ndihmën e askujt. Por, duhet të keni parasysh që, këto qeliza nuk



janë qenie njerëzore si ne. Ato as nuk mund të shohin dhe as të dëgjojnë njëra tjetrën, por as të marrin vendime "për të kryer punë inteligjente". Ato s'kanë as veshë, as mend. Ato nuk kanë studiuar për kimi, por, siç do ta shohim edhe në faqet e mëposhtme, ato kanë njohuri për formulat kimike dhe

mund të prodhojnë substanca duke u bazuar mbi këto formula. Po si ndodh që ato dinë të bëjnë gjithë këto gjëra?

Ju do të mbusheni me admirim duke lexuar dhe do të zbuloni që qelizat nuk i kryejnë të gjitha këto detyra në sajë të zgjuarsisë së tyre. Ju, gjithashtu, duhet të jeni të vetëdijshëm që nuk ka



mundësi që ato të kenë mësuar se si t'i kryejnë këto detyra rastësisht, thjesht me kalimin e kohës.


Megjithatë, jeta jonë u detyrohet veprimeve të vetëdijshme të këtyre qenieve të vogla, të cilat ne nuk mundemi t'i shikojmë, madje, as me sy të lirë. Patjetër që, në



Në secilën prej qelizave të trupit tone, të cilat janë shumë të vogla për tu parë me sy të lirë, kryhen më shumë procese se sa në laboratorin më poshtë.



to ka një fakt mjaft të rëndësishëm për t'u kuptuar. Ekziston një zotërues i një mençurie të përsosur që u mundëson qelizave tona t'i kryejnë gjithë këto detyra dhe u mëson atyre se çfarë të bëjnë. Zotëruesi i kësaj diturie dhe urtësie të përjetshme është Allahu, i Cili ka krijuar çdo gjë. Ai na do ne dhe Ai i njeh të gjithë nevojat dhe dobësitë tona.




Në pikturën më sipër mund të shihni brendësinë e një qelize. Në qendër të saj ndodhet bërthama, e cila rrethohet nga pjesët e tjera të qelizës.





Secila nga trilionat e qelizave të trupit tonë e përmbush detyrën e saj në mënyrë të përsosur, si rezultat i një plani të përkryer të Allahut, në mënyrë që ne të vazhdojmë jetën tonë pa asnjë vështirësi. Zgjimi çdo mëngjes për të shkuar në shkollë, të provuarit e shijes së këndshme të mjaltit, frymëmarrja pa asnjë vështirësi, të vrapuarit dhe luajtja me shokët në oborrin e shkollës, të shkruarit, të lexuarit dhe mjaft gjëra të tjera që ju bëni, kryhen vetëm në sajë të dashurisë, dhembshurisë dhe mëshirës së Allahut.

Ashtu si çdo gjë tjetër mbi tokë, Allahu ju ka krijuar në mënyrë të përkryer dhe ju ka dhënë çdo gjë që ju keni nevojë. Ajo çfarë ju mbetet të bëni është që ta falënderoni Zotin tonë, i Cili ju ka dhënë gjithë këto mirësi, të cilat janë dhurata më e vyer se çdo dhuratë tjetër që mund t'ju jepet në këtë botë.



Për këtë arsye, ne na duhet të mendojmë në mënyrë të hollësishme rreth bekimeve që Allahu ka derdhur mbi ne. Në vargjet e Kur'anit, Librit tonë të Shenjtë, Allahu ka dhënë mjaft shembuj për ne që të mendojmë thellë rreth tyre. Ajeti i mëposhtëm është një i tillë:

Është fakt që, në krijimin e qiejve dhe të tokës, në ndërrimin e natës e të ditës, të anijes që lundron në det që u sjell dobi njerëzve, në atë shi që e lëshon Allahu prej së larti e me të ngjall tokën pas vdekjes së saj dhe përhap në të nga çdo lloj gjallese, në qarkullimin e erërave dhe reve të nënshtruara ndërmjet qiellit dhe tokës, (në të gjitha këto), për një popull që ka mend ka argumente. (Sure El-Bekare: 164)

Në këtë libër, ne do të mendojmë rreth trupit tonë. Do të shohim se sa përsosmërisht dhe të ndërlikuar e ka krijuar Allahu trupin i njeriut. Pasi të keni lexuar librin, ju do ta doni Allahun akoma më shumë dhe do ta falënderoni Atë. Po ashtu, do të çuditëni me moskokëçarjen e madhe të njerëzve që ju rrethojnë, të cilët nuk mendojnë dhe nuk meditojnë, dhe do të jeni të etur për t'u treguar atyre çfarë mësuat, në mënyrë që edhe ata të jenë më të vëmendshëm ndaj këtyre mirësive.



NJË FABRIKË GJIGANDE QË NUK SHIHET ME SY TË LIRË: QELIZA

A

shtu siç e përmendëm edhe në fillim të librit, trupi ynë përbëhen nga trilion qeliza. Ky

numër nuk mund të kalohet pa u vënë re. Në të vërtetë një trilion është një numër jashtëzakonisht i madh. Trupi i një njeriu të rritur përmban rreth 100 trilion qeliza. Por, duke qenë se, këto qeliza janë shumë të vogla, trupi ynë nuk ka përmasa gjigante. Do të sjellim një shembull për t'ju ndihmuar të kuptoni më mirë se, sa të vogla janë qelizat. Po të marrim dhe të bashkojmë një milion qeliza së bashku, ato nuk zënë më shumë vend se një majë gjilpëre. Megjithatë, pavarësisht se ajo është jashtëzakonisht e vogël, ndërtimi i saj akoma nuk është kuptuar plotësisht. Shkencëtarët ende vazhdojnë kërkimet e tyre për të kuptuar sistemet që përmban një qelizë.

Qeliza e parë që ju formoi juve, filloi të krijohet në barkun e nënës tuaj nga bashkimi i dy

qelizave, njëra e çliruar nga trupi i nënës dhe tjetra nga trupi i babait tuaj. Kjo qelizë vazhdoi të ndahej dhe, më vonë, u bë sa një copë mishi. Më pas, ndërsa ato qeliza që formuan këtë copë mishi vazhduan të ndahen, duke formuar qeliza të reja, trupi juaj pak e nga pak filloi të marrë formë.


Kështu, qelizat e reja morën forma të ndryshme. Disa prej tyre u bënë qeliza gjaku, ndërsa disa u bënë qeliza kockore dhe disa të tjera u bënë qeliza nervore. Në trupin tonë ndodhen 200 lloje të ndryshme qelizash.

Në fakt, të gjitha këto qeliza janë të përbëra nga të njëjtët përbërës, por pavarësisht nga kjo, secila prej tyre kryen detyra të ndryshme. Për shembull, qelizat e muskujve të kofshës janë në formën e një litari të gërshetuar në mënyrë të tillë që ju të ecni dhe të vraponi. Në sajë të ndërtimit që kanë, muskujt e krahëve dhe të këmbëve tuaja nuk këputen nga tërheqja e tepërt kur jeni duke luajtur me top. Në formë, qelizat tuaja





Qelizat që ndahen dhe shumohen, siç pamë në figurën më lart, më pas ndahen në qindra tipe të ndryshëm qelizash, disa prej të cilave tregohen më poshtë.



ind muskolor



qelizë nervore



qeliza lëkure



rruazat e kuqe të gjakut

të gjakut janë sferike dhe detyra e tyre është të transportojnë oksigjenin, aq të kërkuar nga trupi juaj, nëpërmjet enëve të gjakut. Falë formës së tyre, ato mund të rrjedhin me lehtësi përmes enëve të gjakut së bashku me oksigjenin që ato mbartin.

Qelizat e lëkurës, nga ana tjetër, janë kapur fort me njëra tjetrën dhe janë radhitur ngushtë në një vijë të drejtë. Ndaj, lëkura juaj është e papërshkueshme nga mikrobet dhe uji.

Dhe kështu me radhë, të gjitha qelizat e tjera, po ashtu, kanë forma saktësisht të përsosura, që janë të përshtatshme për të kryer detyrat e tyre. Megjithatë, është e sigurt që, këto qeliza nuk e fituan formën që kanë rastësisht. Le të marrim për shembull kompjuterët, makinat ose aeroplanët. Dikush i shpiku format

dhe sistemet e nevojshme për punën e secilës prej këtyre pajisjeve. Edhe detajet më të imta përcaktohen dhe merren parasysh nga inxhinierët teknologë të kompanive prodhuese të këtyre pajisjeve. Makinat prodhohen në mënyrë të tillë që të sigurojnë një udhëtim të sigurt dhe të rehatshëm. Televizorët janë prodhuar në mënyrë të tillë që të transmetojnë tinguj dhe imazhe pamore të një cilësie të lartë për shikuesit. Të njëjtën gjë mund të themi, jo vetëm për pajisjet teknologjike, por, për çdo objekt që përdorim në jetën tonë. Tryezat, karriget, ndërtesat ku jetoni, lapsat që përdorni, mjetet e ngrënies si: lugët dhe pirunjtë e kuzhinës ... secili prej tyre është rezultat i një projektimi. Secili prej tyre është përcaktuar në mënyrë të detajuar, dhe asgjë nuk ka ardhur në ekzistencë rastësisht. Siç e dini, në mënyrë që të krijohet një projekt dhe një produkt, duhet të ekzistojë patjetër një burim inteligjence.




Fijet më sipër janë bërë nga ekspertë të specializuar në këtë fushë, që do të thotë se, secila nga ato është produkt i një procesi projektimi.

Tani, le t'i kthehemi qelizave të trupit tonë. Qelizat tona kanë detyra dhe planifikim shumë më të përparuar se sa një televizor apo çdo pajisje tjetër teknologjike. Për më tepër, këto njësi ndërtimore apo pjesë përbërëse,



Këto enë depozitimi furnizojnë me lëndë ushqimore.



Pjesët e qelizës quhen organele. Secila nga organelet ka një detyrë të veçantë.

Bërthamëza: Kjo organele prodhon dhe depoziton ribozome.

Lizozomet: Organelet tretëse të qelizave shkatërrojnë mbetjet dhe substancat e rrezikshme


Bërthama: "Truri" i qelizës mban gjenet dhe drejton aktivitetet e qelizës.

Ribozomet: Këto fabrika prodhojnë proteina që përdoren nga qeliza.


Trupat e Golxhit: Këto qeska të gjata përgatisin prodhimet e qelizës për eksport

Mitokondritë: Këto centrale elektrike prodhojnë energji për të furnizuar me energji aktivitetet e qelizës.

Le të japim një shembull për t'ju ndihmuar të kuptoni se sa i mrekullueshëm dhe sa i ndërlikuar është ndërtimi i qelizës: Ajo mund të krahasohet me një qytet të madh me të gjitha sistemet e përpunimit në të. Në këtë qytet ka bimë për të dhënë energji, fabrika për të prodhuar lëndët e nevojshme, magazina për t'i ruajtur ato, tuba për të transportuar materialet, po ashtu edhe laboratorë dhe rafineri. Ne vazhdojmë të jetojmë falë punës së përsosur të këtyre sistemeve në qelizat tona. Por, mos harroni se përmasat e një qelize, në krahasim me një qytet të madh, nuk janë me mijëra kilometra katrore, por vetëm një të qindtat e milimetrit.



1 ●●●●▶



2 ●●●●▶



3 ▼

FËMIJË! Ndiqni shigjetat dhe shihni rradhën e veprimeve që kryhen në një qelizë.



të cilat kanë veçori të jashtëzakonshme, janë të gjalla. Ashtu siç e kemi përmendur edhe më parë, shkencëtarët akoma nuk e kanë zbuluar plotësisht tërësinë e mahnitshme të këtyre pjesëve të vogla.

Ju ndoshta po pyesni veten, apo jo, si erdhi në jetë një projekt i tillë, të cilin mendja njerëzore akoma nuk ka mundur ta zbulojë plotësisht, brenda një hapësire aq të vogël?


Kjo na tregon se, qelizat tona janë përcaktuar dhe krijuar nga një qenie me mençuri të pashembullt. Zotëruesi i kësaj mençurie është Allahu, i Cili na krijoi në mënyrë të përkryer deri në grimcën më të vogël.



4 ▼ 5



- 1-2: Çdo përbërës i huaj ndalohet për kontroll në hyrje të qelizës.
- 3: Brendesia e qelizës i ngjan një fabrike që punon pa ndërprerë.
- 4. Në qendër të qelizës është bërthama, që shërben si një qendër analizimi të dhënash.
- 5. Qeliza ka gjithashtu një vend që funksionon si rafineri.



NJË RRJET GJIGAND QË PËRSHKON TRUPIN TONË

A

e pyetur ndonjëherë veten?

✓ A të marr frymë?


✓ A është e mjaftueshme sasia e gjakut që pompon zemra ime?

- ✓ Sa energji kërkojnë secila nga qelizat dhe organet e trupit tim?
- ✓ Kur duhet ta fillojë stomaku im tretjen e ushqimit që kam ngrënë?
- ✓ A është intensiteti i dritës që hyn në syrin tim në sasinë e duhur?
- ✓ Cilët muskuj duhet të tkurr që ta lëviz krahun?

Këto pyetje tingëllojnë të çuditshme, apo jo? Kjo ndodh sepse ne asnjëherë nuk i bëjmë vetes pyetje të tilla. Por për më tepër, ne nuk jemi as të vetëdijsëm për kryerjen e vazhdueshme të këtyre ndryshimeve të pandërprera. Trupi ynë i kryen të gjitha këto zhvillime në mënyrë automatike. Ai përdor rrjetin e nervave për të realizuar këto detyra. Ky rrjet përbëhet nga bashkëveprimi i



triliona qelizave nervore, siç mund t'i shihni edhe në këto faqe. Këtë rrjet nervash, të cilat arrijnë në çdo cep të trupit, mund ta krahasojmë, me një autostradë, siç mund të shihet edhe në figurë. Në sajë të këtij rrjeti, qelizat në trurin tonë lidhen me qelizat e muskujve të këmbëve dhe të gjitha qelizat e trupit tonë komunikojë me njëra tjetrën. Por, sistemi ynë nervor ka një ndërtim më të ndërlikuar dhe gjithëpërfshirës sesa kilometra të tëra autostrade, të cilat mund të kenë shumë kryqëzime dhe kors për automjetet që udhëtojnë në drejtime të kundërta. Ashtu sikurse automjetet udhëtojnë nga një vend tek një tjetër me anë të autostradave, po ashtu edhe



impulset nervore elektrike transmetohen përmes rrjetit të nervave që përshkojnë tërë trupin tonë. Këto impulse transportojnë mesazhe nga një pjesë tek një pjesë tjetër e trupit. Këto impulse lëvizin në trupin tuaj me një shpejtësi të paimagjinueshme. Për shembull, kur ti dëshiron të përthyesh krahun, nga truri yt merr udhën një stimul elektrik. Gjatë këtij udhëtimit të ndërlikuar, ky stimul së pari ndalon pranë shtyllës kurrizore. Më pas, ai vazhdon rrugën për tek organi në fjalë, të cilit duhet t'i përçohet mesazhi. Muskuli i krahut tuaj tkurret i tëri dhe ju arrini të përthyesi krahun tek bërryli. Kjo seri veprimesh ndodh në të mijtat e sekondës.

Duke menduar që, për të hapur dhe mbyllur sytë ngadalë duhet përafërsisht një sekondë, nga kjo kuptohet sa kohë e shkurtër është një e mijta e sekondës. Ngjashëm, trurit tonë i dërgohen stimuj nga i tërë trupi me anë të nervave. Trurit i dërgohen mesazhe në mënyrë të vazhdueshme nga çdo pjesë, sado e vogël e trupit dhe me një





Qelizat nervore janë pa pushim të zëna gjatë gjithë aktiviteteve të ditës.

shpejtësi mahnitëse. Në këtë mënyrë ju mund të flisni, të qeshni, të vraponi, të shijoni një akullorë, të luani me qenin tuaj... të gjitha këto vargje veprimesh ndodhin pa asnjë ndërprerje; juve ju mjafton t'ju shkojë në mendje një veprim dhe e kryeni atë menjëherë. E shikoni një objekt porsa ia hidhni vështrimin, i dëgjoni fjalët në atë kohë kur fliten, dhe ndjeni nëse një objekt është i nxehtë apo i ftohtë porsa e prekni. Të gjitha këto realizohen në sajë të harmonisë së përkryer ndërmjet trurit dhe sistemit tuaj nervor. Me të vërtetë, impulsat nervore janë duke u përçuar në trupin tuaj pikërisht edhe në këtë moment që ne po flasim. Nervat që gjenden në mollëzat e gishtërinjve në këtë moment që ju po lexoni këtë libër, po i dërgojnë mesazhe trurit tuaj në lidhje me peshën e librit që po mbani në duar, në mënyrë që ta mbani





Truri juaj merr, përmes nervave të shpërndara në të gjithë trupin, vazhdimisht stimuj nga pjesët e tjera të trupit. Truri i vlerëson këto stimuj dhe u përgjigjet pjesëve të duhura të trupit. Për shkak të këtyre përgjigjeve që sigurohen nga truri, ju mundeni të lëvizni, shikoni, dhe dëgjoni.

ngritur atë me një forcë që i përshtatet peshës së tij. Në të njëjtën kohë, trurit i dërgohen stimuj nga sytë tuaj, hunda, këmbët po ashtu edhe nga shumë pjesë të tjera të trupit tuaj.

Truri juaj i analizon këto stimuj ardhës dhe u dërgon përgjigje të përshtatshme pjesëve në fjalë të trupit tuaj, dhe këto të fundit veprojnë sipas këtyre përgjigjeve. Tani le t'i rikujtojmë të gjitha këto veprime. Në trupin tuaj ndodhin njëkohësisht shumë vargje veprimesh të pandërprera. Ndërsa jeni duke lexuar një libër, në të njëjtën kohë, ju dëgjoni zëra nga bota e jashtme, ndjeni përkëdheljen e butë të maces tuaj ndërsa ajo kalon në këmbët tuaja, shijoni shijen e lëngut të ndonjë fruti që po pini, zemra juaj vazhdon të rrahë dhe shumë veprime të tjera marrin pjesë në të njëjtën kohë në trupin tuaj.



Çfarë do të ndodhte nëse do t'u jepej juve përgjegjësia për të kontrolluar të gjitha këto procese vetëm për pak sekonda? Sigurisht që ju nuk do të ishit në gjendje t'i kontrollonit të gjitha në

të njëjtën kohë. Por, megjithatë, në sajë të krijimit të përkryer të Allahut, truri juaj dhe pjesët e tjera të trupit tuaj veprojnë së bashku dhe i kryejnë të gjitha këto detyra pa pasur nevojë për ndonjë ndërhyrje nga ana juaj. Të gjitha llojet e informacioneve transmetohen nga trupi për tek truri juaj në formën e stimujve elektrikë, të cilët kanë nevojë që të interpretohen. Vetëm atëherë ju mund të provoni butësinë e përkëdheljes së qenushit tuaj, freskinë e erës, shijen e lëngut të pjeshkës, erën e këndshme të patateve të skuqura. Mirë, atëherë, a mendoni se është e mundur për trurin tuaj, i cili është vetëm një copë mishi që nuk peshon më shumë se 1.5 kilogram, t'i përmbushë të gjitha këto detyra vetë? Sigurisht që jo. Vetëm në sajë të krijimit të mrekullueshëm të Allahut, truri juaj mund t'i kryejë të gjitha këto detyra në të njëjtën kohë.





Ju do të hapni dhe mbyllni sytë me shpejtësi kur një miku juaj ju afrohet pa zhurmë dhe shihni papritur duart e tij para syve tuaj dhe ju nuk e keni vënë re ardhjen e tij apo të saj. Nuk ka zgjedhje tjetër, sepse ky

është refleksi. Refleksi është një përgjigje e menjëhershme dhe e pavullnetshme. Arsyeja përse kjo përgjigje është kaq e shpejtë është sepse stimujt, në raste të tilla nuk transmetohen në tru, por përgjigjja e kërkuar merret direkt nga shtylla kurrizore. Kjo është një dhuratë e rëndësishme që Allahu krijoi për ne, sepse falë këtyre reflekseve, ne jemi të mbrojtur nga shumë rreziqe. Për shembull, ju e tërhiqni menjëherë dorën kur prekni një gotë të nxehtë. Refleksi është një mekanizëm sigurie që Allahu krijoi në trupin tonë për të na mbrojtur. Me frymëzimin e Allahut, stimujt nervorë lëvizin me një shpejtësi afërsisht 9 kilometra në sekondë dhe në këtë mënyrë ju jeni të mbrojtur nga shumë rreziqe.




SI PUNON TRURI?

Shpërndani mbi dyshe me në mënyrë të çrregullt pjesët e një loje enigme, me forma të ndryshme të një figure dhe supozoni që këto pjesë janë e tërë njohuria që keni rreth botës. Për shembull, lë të supozojmë që disa prej këtyre formave përfaqësojnë dritën, disa të tjera përfaqësojnë ngjyrat, dhe disa të tjera tingujt. Tani merrini këto pjesë një nga një dhe filloni t'i bashkoni për të formuar figurën si të tërë. Për të realizuar detyrën e mësipërme juve ju duhet një kohë e gjatë të menduari, ndërsa truri juaj e realizon këtë në të qindtat e sekondës, i cili funksionon në sajë të frymëzimit të dhënë nga Allahu. A e dini si e bën ai këtë?

Truri mbledh informacionet e mara nga sytë, hunda, veshët, lëkura, goja etj., dhe i interpreton ato. Ai që e mundëson këtë interpretim, është bashkimi i 100 bilion qelizave nervore të trurit. Këto qeliza veprojnë në mënyrë të vazhdueshme dhe ju bëjnë të mundur të shihni ngjyrën e mollës që po hani, të njihni zërin e një mikut tuaj të ngushtë dhe të perceptoni aromën e një çokollate të ngrohtë.


Pamja në faqen tjetër tregon në brendësi të trurit disa fëmijë që janë duke folur, duke dëgjuar, duke nuhatur dhe duke fjetur.

Sigurisht që kjo është një figurë imagjinare, që ka si qëllim të tregojë pjesët e veçanta të trurit dhe detyrat e tyre. Në të vërtetë, truri është i përbërë nga qeliza nervore, të cilat mund të shihen vetëm me mikroskop. A mendoni që vetë qelizat tuaja nervore mund të shikojnë kukullën tuaj të preferuar ose të shijojnë shijen e një akulloreje me çokollatë? Sigurisht që jo. Kjo për arsye se,



qelizat nervore janë të përbëra prej pjesësh fare të imta mishi. Kështu që me doemos duhet të ekzistojë një qenie tjetër me fuqi të madhe, i cili e ka krijuar

Qeliza në të majtë me ato zgjatimet si flokë është një qelizë nervore (neuron). Bilionë qeliza nervore, që ndërlidhen nëpërmjet këtyre degëve që dalin nga trupi i qelizës, formojnë një rrjet (nervor) pikërisht në trupin tuaj. Midis fundeve nervore ekzistojnë hapësira, dhe sinjalet nervore u transmetohen qelizave të tjera nervore përmes këtyre hapësirave.



këtë botë të mrekullueshme. Kjo qenie është Allahu. Allahu, pronari i çdo gjëje, krijon çdo gjë në mënyrë të përkryer dhe na paraqet secilit prej nesh një jetë të mrekullueshme dhe të bukur. Ajo çfarë ne duhet të bëjmë në këmbim të kësaj mirësie është që të jemi mirënjohës dhe falënderues ndaj Zotit tonë. Për shembull Allahu na ka dhënë sytë dhe veshët, dhe na ka urdhëruar ta falënderojmë Atë për këto:

Është Ai që krijoi të dëgjuarit, të parët dhe zemrat për ju. Sa pak jeni falënderues! (Sure Mu'minun:78)



UDHËTIMI QË BËN USHQIMI NË TRUPIN TONË

E

nergjinë e nevojshme për
nevojat trupore ne e sigurojmë
nga ushqimet dhe pijet e ndryshme.

Megjithatë, çdo ushqim që hamë, për shembull makaronat, mishi apo bananet, fillimisht, ka nevojë të tretet para se të jetë i gatshëm të përdoret nga trupi ynë. Ato përdoren nga qelizat e trupit pasi të jenë tretur. Sheqeri që përmban një banane apo një mollë siguron karburantin për qelizat tuaja dhe rrit energjinë; proteinat që përmban mishi janë thelbësore për rritjen e numrit të qelizave tuaja, pra kështu edhe të trupit tuaj. Tani mundohuni të ktheheni mbrapa në kohë, në foshnjërinë tuaj.

Kur lindët, ju ishit afërsisht 2-3 kilogram. Pesha juaj rritet në 30-35 kilogram kur ju jeni 10 vjeç, në 40-50 kilogram kur arrini moshën 15 vjeç dhe 50-60 kilogram kur arrini moshën 20-25 vjeç.

Arsyeja për këtë ndryshim
kaq të



1 Vjeç



7 Vjeç



11 Vjeç

madh është fakti që, sasia e ushqimeve që konsumoni i shtohet trupit tuaj me kalimin e kohës. Disa nga këto ushqime sigurojnë energjinë që ju nevojitet për të ngarë bicikletën, për të vrapuar dhe për të

luajtur, ndërsa një pjesë e tyre i shtohen trupit tuaj dhe formojnë mishin dhe kockat tuaja. Materialet e tepërta shkarkohen jashtë trupit. Të gjitha këto veprime kryhen në sistemin tuaj tretës. Gjendrat dhe organet si: stomaku, zorrët dhe pankreasi kanë rolin e tyre në procesin e tretjes.

Puna e aparatit tretës është e ngjashme me punën e një rafinerie naftë. Nafta e papastër që vjen në rafineri si material i papërpunuar ku, përpunohet nga makineri të posaçme dhe rafinohet në mënyrë të tillë që të bëhet e përdorshme. Ushqimet që hamë në fazën e parë janë materiale të papërpunuara, më pas ato përpunohen në stomak, në mënyrë që të përdoren nga trupi. Pasi të jenë copëtuar në stomak dhe në zorrë, ushqimet e



ngrëna bëhen gati për t'u përdorur si ushqim për qelizat dhe transportohen në vendet e përshtatshme të trupit nëpërmjet enëve të gjakut.

Në një rafineri naftë, nga përpunimi i një substance fillestare, dalin një sërë nënproduktesh, për shembull benzina, e cila përdoret si karburant për automjetet, ose goma që përdoret si shuall për këpucët tuaja. Ngjashëm, lëndët ushqyese që gjenden në ushqimet që hani,

**GJATËSIA TOTALE
E APARATIT
TRETËS, DUKE
FILLUAR NGA
GOJA DERI NË
FUND TË
ZORRËVE, ËSHTË
10 METRA.**

Gjëndrat e pështymës sekretojnë pështymë, e cila fillon copëzimin e ushqimit.

Ushqimi fillimisht është në formën e karbohidrateve komplekse.

Karbohidratet më pas copëzohen në sheqer të thjeshtë.

Insulina i tregon mëlçisë që ta ruajë glukozën në formën e glikogjenit.

Glukagoni i tregon mëlçisë ta transformojë glikogjenin në glukozë.

Kur sasia e sheqerit në gjak është e ulët, pankreasi dërgon hormonin glukagon në mëlçi.

Kur sasia e sheqerit në gjak është e lartë, pankreasi dërgon në mëlçi hormonin insulinë.


Glukoza shkon në mëlçi.

Mëlçia ruan një pjesë të glukozës si glikogjen.

Pankreasi sekretion disa lloje enzimesh në pjesën e fillimit të zorrës së vogël.

Enzimat që gjenden në pjesën e fillimit të zorrës së hollë i shpërbëjnë karbohidratet në sheqer të thjeshtë.

Glukoza përthithet duke kaluar në rrjedhën e gjakut.



ndahen në yndyrna, sheqerna dhe karbohidrate në stomakun tuaj. Por, duhet të keni parasysh se, ajo që ndodh në stomakun tuaj pasi keni ngënë



një sanduic të shiishëm, është shumë më e ndërlikuar se ajo që ndodh në një rafineri. Por, për më tepër, këto seri veprimesh, të cilat ne do t'i diskutojmë më poshtë, nuk marrin pjesë në ndonjë fabrikë gjigande, por në një zonë shumë të vogël brenda trupit tuaj.

Gjatësia e plotë e rrugës, nëpër të cilën i duhet të kalojë ushqimit në mënyrë që të tretet, është 10 metra. Kjo gjatësi është afërsisht 6-7 herë më e madhe se gjatësia mesatare e trupit të njeriut dhe është diçka e mahnitshme se, si një kanal i tillë është përshtatur në trupin tonë. Si ka mundësi që një kanal i tillë kaq i gjatë të jetë vendosur në trupin e njeriut? Përgjigjia e kësaj pyetje tregon edhe një herë tjetër që ekziston një projektim i veçantë në krijimin e trupit tonë.

Siç mund ta shihni edhe në figurë, meqenëse aparati i tretjes është mbledhur kruspull, pavarësisht nga gjatësia e tij, ai është përshtatur në një zonë shumë të vogël. Kjo formë e veçantë është një projektim i përkryer i Zotit tonë, i Cili ka krijuar çdo gjë. Kjo veçori e sistemit të tretjes është vetëm njëra nga mrekullitë që Allahu ka krijuar në trupin tonë.



A e dini përse dhëmbët tuaj kanë forma të ndryshme?

Arsyeja se përse dhëmbët kanë forma të ndryshme është sepse secili prej tyre ka detyra të ndryshme. Për shembull dhëmbët tuaj të parë janë të mprehtë, në mënyrë që ju mund të kafshoni një mollë me lehtësi. Çfarë do të ndodhte sikur dhëmballët tuaja të ishin përpara? Po, keni të drejtë. Ju nuk do të ishit në gjendje ta kafshonit mollën me të tillë dhëmbë. Po ashtu, nëse dhëmbët tuaj të parë do të ndodheshin në pjesën e prapme të gojës, ju nuk do të ishit në gjendje ta bluanit ushqimin që ju hani.

Ashtu si çdo pjesë, sado e vogël e trupit tuaj, edhe dhëmbët në gojën tuaj janë rregulluar nga Allahu në mënyrën më të përshtatshme dhe më të favorshme për ju.

Në pjesën e prapme të gjuhës jetojnë bakterie të dobishme.



Bakteriet në përgjithësi njihen si shkaktare sëmundjesh, dhe, për të qenë të mbrojtur nga efektet e tyre të dëmshme, njerëzit duhet të jenë të kujdesshëm në lidhje me pastërtinë si të trupit, ashtu edhe të ambientit ku jetojnë. Por, megjithatë, jo shumë kohë më parë, shkencëtarët zbuluan praninë e disa bakterieve të dobishme në trupin e njeriut, dhe në veçanti, në pjesën e prapme të gjuhës. Po, fjalinë e mësipërme e lexuat saktë; ka edhe bakterie të dobishme në trupin tuaj. Detyra e bakterieve në fund të gjuhës është që të ngordhin mikrobet e dëmshme që ndodhen në stomakun tuaj. Por, sigurisht që, kjo nuk është një detyrë e lehtë dhe për këtë kërkohen një seri veprimesh. Para së gjithash, këto bakterie shndërrojnë nitratin që gjendet në perimet jeshile në nitrit. Megjithatë, procesi nuk ka mbaruar ende. Nitriti, në bashkëpunim me pështymën që sekretohet në gojë, ka një efekt vrasës ndaj mikrobeve. Me fjalë të tjera, bakteriet që ndodhen në fundin e gjuhës ndihmojnë në prodhimin e një substance mikrobvrasëse. Siç e dini, mikrobet shkaktojnë sëmundje të ndryshme. Falë bakterieve të dobishme që prodhojnë një substancë mikrobvrasëse, ju jeni të mbrojtur ndaj shumë sëmundjeve. Këto bakterie të dobishme janë një nga shfaqjet e mëshirës së Zotit tonë, i Cili e krijoi trupin tonë në mënyrën më të përsosur. Allahu na ka dhënë shumë bukuri dhe dhurata. Për të treguar pamundësinë për t'i numëruar këto dhurata në një ajet Kur'anor thuhet si më poshtë:

Nëse do të mundoheshit t'i numëronit mirësitë e Allahut, ju kurrë nuk do të arrinit t'i numëronit ato. Allahu është i Mëshirshëm





SI E TRET STOMAKU USHQIMIN?

Tani le të ndërmarrim një studim më të hollësishëm të procesit të tretjes. Sillni ndër mend frymëmarrjen, të notuarit, ngarjen e një biçiklete, të ngrënit... Këto veprime janë pjesë e jetës sonë të përditshme, megjithatë, në pjesën më të madhe të kohës ne as nuk na shkon në mendje se si ndodhin këto veprime. Trupi ynë ka nevojë për energji. Ne tashmë e kemi shpjeguar që këtë energji e marrim nga ushqimi që hamë. Por ushqimi që kërkon trupi duhet të jetë i thjeshtë dhe i grimcuar në përmasa të tilla që të jetë në gjëndje të kalojë nëpër enët e gjakut. Përndryshe, ai nuk do të ketë mundësi të depërtojë në qeliza. Megjithatë, ushqimet që hamë gjenden në copa të mëdha. Kështu që na nevojitet një makineri që t'i bëjë të mundur trupit tonë ta përdorë ushqimin që hamë. Në fakt, ne mund ta quajmë shkurt këtë një mulli, i cili në parim copëton ushqimin që ne hamë në pjesëza më të





vogla. Kjo makinë bluajtëse në trupin tuaj, quhet “aparati tretës”.

Ky aparat, si çdo makineri, përbëhet nga pjesë përbërëse të ndryshme dhe, në sajë të punës së përkryer të secilit prej këtyre pjesëve, ne mundemi të tresim ushqimin. Por është thelbësore që, pjesët përbërëse të aparatit tretës të



funksionojnë në harmoni dhe në mënyrë të plotë sepse, përndryshe, prishet tërësisht aparati.

Lë të sjellim një shembull për të ilustruar se përse të gjitha pjesët përbërëse të aparatit duhet të jenë të plota për punën e saktë të tij:

Një makinë

lodër me

telekomandë

përbëhet nga

pjesë të tilla

si: rrotat,

pajisja e

kontrollit, motori,


bateritë, ingranazhet, bobina elektrike,

antena etj. Në mënyrë mjaft të ngjashme, aparati

tretës është i përbërë nga pjesë përbërëse të ndryshme.

Këto organe përfshijnë: dhëmbët, gojën, ezofagun, stomakun dhe zorrët.

Tani mendoni, a do të punonte një makinë me telekomandë nëse ajo nuk do të kishte antenë apo rrota? Sigurisht që jo. Makina mund të ecë vetëm nëse ajo i ka të gjitha pjesët e saj. Të njëjtën gjë mund të themi edhe për aparatit tretës. Prania e stomakut do të ishte e pakuptimtë



nëse nuk do të kishte gjithashtu edhe një ezofag, sepse ai që e transporton ushqimin për në stomak është ezofagu. Në të njëjtën mënyrë, zorrët nuk do të kishin ndonjë dobi nëse nuk do të ekzistonte stomaku, për arsye se ushqimet që treten në stomak më pas kalohen për në zorrë, vend ku ushqimit i jepet forma e duhur që të jetë i përshtatshëm për t'u transportuar në qelizat e trupit.

Kjo na tregon qartë që Zoti ynë, Krijuesi i çdo gjëje, ka krijuar për ne një sistem që është i përkryer nga çdo anë që ta studiojmë. Kjo tregon edhe një herë që nuk ka zot tjetër përveç Zotit tonë:

Zoti juaj është vetëm Allahu, që nuk ka zot tjetër përveç Tij. Ai ka përfshirë çdo gjë me diturinë e Tij.
(Sure Ta Ha: 98)



MAKINA TRETËSE FILLON PUNËN...



Tretja fillon në gojë. Karbohidratet që gjenden në ushqimet që ju hani, pikësëpari copëtohen në copa më të vogla nga pështyma që gjendet në gojën tuaj. Për shembull, ushqimi që ju hëngrët në mëngjes fillimisht filloi të copëtohej në gojë. Por, që të zbërthehet plotësisht djathi së bashku me bukën që ju hëngrët,

fshikëza e tëmthit

pankreasi

stomaku

nevojitet një kohë më e gjatë. Lëndët ushqimore të copëtuara në gojë kalojnë përmes ezofagut dhe arrijnë në stomak. Në stomak merr pjesë një tjetër gjendje e mrekullueshme ekuilibri. Tretja e ushqimit në të kryhet nga një lëng shumë i fortë. Ky lëng është acid klorhidrik. Ashtu siç e dini, acidet janë materiale gërryese. Ato janë në gjendje të shpërbëjnë çfarëdo lloj gjëje me të cilën ato bien në kontakt. Për shembull, ajo çka nënat tuaja përdorin për të pastruar një prizë me vrima të bllokuara është një lëndë më përmbajtje acide. Për të shkatërruar papastërtitë apo hedhurinat që kanë bllokuar p.sh. tubin e lavamanit, janë lëndët acide ato që mundësojnë zhblokimin nga këto papastërti. Pikërisht, falë acidit të fortë që gjendet në stomak ushqimet, të cilat janë në copa të



Ky është All-llahu, Zoti juaj, nuk ka të adhuruar përveç Tij, Krijues i çdo sendi, pra adhuroni Atë; Ai është mbikëqyrës ndaj çdo sendi. Të parët (e njerëzve) nuk mund ta përfshinë Atë, e Ai i përfshinë të parët. Ai është shumë i kujdesshëm, hollësisht i njohur.

mëdha, kur mbërrijnë fillimisht në stomak, zbërthehen në pjesëza më të vogla në mënyrë që të përdoren nga trupi. Por, është ende një pikë tjetër që duhet vënë re.

Kemi përmendur që ushqimi i ngrënë zbërthehet në pjesëza të vogla nga stomaku ose acidet e stomakut. Por, si ka mundësi që ky acid nuk e shkatërron vetë stomakun, i cili është i përbërë prej mishi? Tani,

mendoni rreth kësaj çështjeje. Acidet e stomakut tresin mishin që p.sh., hëngrët për darkë, dhe nuk gërryen stomakun, i cili edhe ai është po ashtu një copë mishi. Pse ndodh kështu? Këtu shpaloset edhe një herë tjetër përsosmëria në krijimin e Zotit tonë. Allahu, i Cili ka krijuar çdo gjë në mënyrë të përkryer, ka projektuar një mburojë në stomak në mënyrë të tillë që ai vetë të mos dëmtohet.

Këtë mburojë mund ta përshkruajmë në mënyrë të përmbledhur si më poshtë; një lëng tjetër që quhet "mukozë", sekretohet në stomak gjatë procesit të tretjes në mënyrë që të pengojë acidin klorhidrik ta shkatërrojë stomakun. Një shtresë e veçantë mukoze shërben si veshje e brendshme e stomakut dhe e mbron atë nga dëmtimi që mund të


STRUKTURA E BRENDSHME E STOMAKUT

qeliza e sipërfaqes së mukozës

plagëz në stomak (difekt i mukozës)



Tipe të ndryshme qelizash të stomakut sekretojnë sekrecione të ndryshme, të cilat shërbejnë për të tretur ushqimet që hamë.



shkaktohet nga ky acid i fuqishëm. Në këtë mënyrë, stomaku nuk tret veten e tij.

Vendndalimi tjetër përgjatë itinerarit të tretjes janë zorrët. Lëndët ushqimore zbërthehen në pjesë akoma më të vogla dhe bëhen kështu të gatshme për përdorim nga trupi, gjatë kalimit të tyre përmes dy zorrëve, zorra e hollë dhe zorra e trashë. Ajo çfarë është e dobishme nga këto lëndë ushqimore futet në sistemin e qarkullimit të gjakut dhe mbetjet e panevojshme shkarkohen jashtë trupit nga sistemi i




jashtëqitjes. Fazat nëpër të cilat ushqimi i ngrënë kalon në zorrë janë gjithashtu shumë të rëndësishme. Tretja vazhdon po ashtu si në stomak edhe në zorrë. Lëndët ushqimore zërthehen në pjesëza akoma më të vogla. Ato tashmë janë aq të vogla saqë mund të përthithen nga enët e gjakut që ndodhen në pjesën e brendshme të zorrëve dhe futen kështu në sistemin e qarkullimit të gjakut për t'u transportuar në çdo pjesë të trupit.

Fëmijë! Ju ju tashmë duhet ta keni kuptuar që sistemi i tretjes është planifikuar në mënyrë të plotë dhe të përkryer. Gjatë udhëtimit të tij, i cili fillon nga goja, vazhdon më tej me ezofagun, stomakun dhe zorrët, ushqimi i ngrënë kalon nëpër disa faza. Dhe më në fund përfitohen lëndët ushqimore që kërkojnë qelizat e trupit tonë. Këto lëndë thithen në zorrë dhe shpërndahen në trup përmes rrjedhës së gjakut. Procesi i tretjes së ushqimit do të ishte shumë i vështirë nëse ky mekanizëm nuk do të punonte në mënyrë kaq të përsosur. Para së gjithash, nëse ne nuk



Një nga funksionet e stomakut, përveç tretjes, është edhe depozitimi: Ushqimi që arrin në stomak qëndron këtu për një periudhë kohe. Më pas, ai pak nga pak kalon në zorrën e hollë për copëzim të mëtejshëm. Nëse ushqimet që hani nuk do të depozitoheshin në stomak, juve do t'ju duhej të hanit çdo 20 minuta, për arsye se stomaku juaj do të mbetej vazhdimisht i boshatisur dhe do të ndjeheshit të uritur gjatë gjithë kohës.





do të kishim dhëmbë, ne nuk do të kishim mundësi të përtypnim ushqimin në mënyrë të mjaftueshme dhe ai nuk



do të kalonte poshtë përmes fytit. Por edhe

nëse do të kalonte, ai do ta dëmtonte keq ezofagun. Nëse stomaku ynë nuk do ta treste ushqimin, çdo gjë që ne do të hanim do të mbetet si një masë e madhe në stomak, gjë e cila do të ishte mjaft shqetësuese. Përveç kësaj, si rezultat i pamundësisë për të tretur ushqimin, trupi ynë nuk do të siguronte ushqimin për të cilin ai ka nevojë. Një trup i paushqyer humbet forcat e tij me kalimin e kohës dhe qelizat e trupit fillojnë të vdesin. Por, ne nuk përjetojmë gjëra të tilla, sepse Zoti ynë krijoi çdo grimcë të trupit tonë në mënyrë të pashembullt. Ky sistem i mrekullueshëm punon në mënyrë të përsosur, dhe ne jemi pothuaj të pavetëdijshëm për të. Kjo mrekulli e krijimit përshkruhet në ajetin e mëposhtëm:

Ai është Allahu - Krijuesi, Shpikësi, Formësuesi. Atij i përkasin Emrat Më të Bukur. Çdo gjë në qiej dhe në tokë e madhëron Atë. Ai është i Plotfuqishmi, i Urti. (Sure El-Hashr:24)



UDHËTIMI I GJAKUT NËPËR - VENA

Në kapitujt e mëparshëm ne shqyrtuam një rrjet gjigant nervash që përshkon gjithë trupin tonë. Ekziston gjithashtu edhe një rrjet tjetër i tillë i mrekullueshëm. Ky rrjet përbëhet nga enët e gjakut. Si rrjeti i nervave, po ashtu edhe enët e gjakut shtrihen gjatë gjithë trupit. Ato janë aq të gjata saqë, në qoftë se do të shtriheshin mbi një sipërfaqe të sheshtë gjatësia e tyre e përgjithshme do të arrinte rreth 100 000 kilometra.

Në fakt, nuk është fare e vështirë të kuptohet që enët e gjakut shtrihen gjatë gjithë trupit tonë. Do të mjaftonte një gërvishtje e vogël në çdo pjesë të trupit dhe ajo menjëherë do të fillonte të rridhte gjak. Kjo tregon se, gjaku qarkullon gjatë gjithë trupit tonë. Për ne është e domosdoshme që të kemi enë gjaku në çdo skaj sado të vogël të trupit për arsye se, siç e përmendëm edhe në kapitullin e mëparshëm, ushqimi që kërkohet nga qelizat e trupit

transportohet përmes enëve të gjakut. Oksigjeni për të cilin qelizat kanë nevojë për mirëfunksionimin e tyre transportohet gjithashtu në gjak përmes venave tona.



Transportimi i lëndëve ushqimore në enët e gjakut mund të krahasohet me transportimin e mallrave me anije. Para se të transportohen, së pari, të gjitha mallrat vendosen mbi anije, në port. Mallrat duhet të paketrohen dhe vendosen në anije në mënyrën e duhur. Pasi çdo gjë është ngarkuar, anija del jashtë portit dhe drejtohet drejt portit ku do të mbërrijë. Kur ajo mbërrin në port, të gjitha mallrat shkarkohen dhe shpërndahen në vendet e duhura. Lëndët ushqimore në enët e gjakut, transportohen nëpër qeliza në mënyrë të ngjashme me anijen që transporton ngarkesa përmes oqeanit. Oksigjeni, yndyrnat dhe aminoacidet rrjedhin në gjak në paketa dhe shkarkohen tek qelizat destinacion. Ky plan transportimi nuk prishet kurrë. Sasitë e duhura të substancave të kërkuara transportohen në qelizat e duhura pikërisht në kohën e duhur. Në të kundërt, p.sh., në qoftë se një qelizë do të kishte nevojë për oksigjen dhe do të merrte yndyrna në vend të tij, kjo do të shkaktonte vdekjen e qelizës. Duhet të vihet re që edhe gabimi më i vogël në këtë sistem do të çonte në dëmtime serioze. Gabime të tilla nuk ndodhin kurrë përveç se në raste të pazakonta, për arsye se asnjë nga këto sisteme nuk erdhi në ekzistencë rastësisht. Allahu, Krijuesi ynë, e shpiku këtë sistem në mënyrë të përkryer për shërbimin tonë.




ÇFARË PËRMBAN GJAKU

Gjatë kohës kur gjaku qarkullon gjatë gjithë trupit, ai përmbush shumë detyra. Tani, le t'i hedhim një shikim të shkurtër këtyre detyrave.



TRANSPORTIMI I PAKETAVE

Ne tashmë e kemi shpjeguar që të gjitha llojet e substancave për të cilat ka nevojë trupi ynë transportohen drejt organeve të caktuara nëpërmjet gjakut. Në të njëjtën kohë, qelizat e gjakut mbledhin materialet e




panevojshme, të tilla si dioksidi i karbonit, dhe sigurojnë shkarkimin e tyre jashtë trupit. Në një farë mënyre gjaku sillet si një makine plehrambledhëse. Duke ndaluar në secilën prej 100 trilion qelizave në mënyrë të vazhdueshme gjatë gjithë ditës, ai u lë qelizave çfarë ato kanë nevojë dhe në të njëjtën kohë mbledh çfarë nuk është e nevojshme.

Gjaku, i cili është thjesht një lëng, mund të kryejë në mënyrë të pagabueshme një detyrë që kërkon shumë vëmendje dhe përgjegjësi.

Ai e njih secilën nga substancat që transporton, për çfarë do të përdoret dhe ku duhet të dërgohet. Për shembull, nuk

transporton gabimisht tek një qelizë dioksidin e karbonit që e ka marrë nga një qelizë tjetër si produkt të padobishëm. Gjithmonë i furnizon qelizat me oksigjen dhe largon prej tyre dioksidin e karbonit. Gjaku e kryen këtë detyrë pa gabime dhe pa lodhje, sepse ai është një pjesë e planit të përkryer që Allahu krijoi në trupin e njeriut. Të gjitha qelizat e gjakut i kryejnë këto detyra pa bërë asnjë gabim, pasi ato i janë nënshtruar në mënyrë të pakushtëzuar sistemit të krijuar nga Zoti ynë.





Siç shikohet në këtë figurë, bakteret ose mikrobet që hyjnë në trup kapen, gëlltiten, dhe kështu çaktivizohen nga qelizat luftëtare të quajtura makrofage.



USHTARËT NË GJAK

Çdo ditë trupi ynë lufton kundër shumë baktereve, viruseve dhe mikrobeve. Një pjesë prej tyre pengohen të hyjnë në trup, ndërsa një pjesë ia del mbanë që të depërtojë. Por, në trupin tonë gjenden qeliza të veçanta mbrojtëse, për të luftuar kundër tyre, që quhen qelizat immune. Këto qeliza, të cilat janë si ushtarë që luftojnë kundër armikut dhe që mbrojnë trupin tonë nga rreziqet, lëvizin në



Në gjak ndodhen tipe të ndryshëm qelizash, ku secila kryen një detyrë të veçantë. Siç shihet edhe në figurën më lart, disa nga këto qeliza transportojnë ushqim, të tjerat si ushtarë, mbrojnë trupin.


rrjedhën e gjakut. Sa herë që ndodh ndonjë sulm nga armiku, ato mund të arrijnë në pjesën përkatëse të trupit lehtësisht përmes enëve të gjakut dhe të luftojnë kundër armikut. Qelizat immune nuk i kanë mësuar vetvetiu misionet e tyre. Ato i kanë ditur ato që në momentin kur u krijuan. Ato fillojnë ta kryejnë detyrën e tyre dhe të ruajnë trupin që në çastin kur lind fëmija. Ky është një detaj i përkryer në krijimin e Allahut. Zoti ynë u ka mësuar qelizave të cilat, nuk mund të shihen me sy të lirë, njohuri shumë të rëndësishme dhe i ka vënë ato në shërbimin tonë.





KOMUNIKIMI

Gjaku gjithashtu shërben si mjet komunikimi në trup. Në gjak ekzistojnë mesazherë të cilët transportojnë mesazhet nga një pjesë e trupit në një tjetër. Këta mesazherë, të njohur si hormonet, transportojnë mesazhe në organet e duhura njësoj si një postier që shpërndan postën. Shumë procese të rëndësishme, që përfshijnë procesin e rritjes së trupit, etjen, procesin e djersitjes dhe kontrollit të nivelit të sheqerit në gjak bëhen vetëm në sajë të saktësisë së shpërndarjes së këtyre mesazheve.



Siç shikohet në figurën sipër, hormonet udhëtojnë nëpërmjet rrjedhës së gjakut së bashku me mesazhet që ato transportojnë dhe i dërgojnë këto mesazhe në organet e duhura.



GJAKU QË SHËRON PLAGËT


Ju duhet ta keni vënë re që kur ndodh ndonjë dëmtim i lehtë i lëkurës gjaku që del prej saj ndalon rrjedhjen vetë pas pak çastesh. Kjo, në të vërtetë, të shtyn të mendohesh thellë, sepse në kushte normale, një lëng që rrjedh nga një vrimë nuk mund të ndalojë rrjedhjen nga dëshira e tij. Për të kuptuar më mirë këtë fakt, imagjinoni se keni një tullumbace të mbushur me ujë. Nëse bëni një vrimë të vogël me gjilpërë në të, uji do të rrjedhë jashtë. A do të ndalojë ai rrjedhjen pas pak kohe pa një ndërhyrje nga ana juaj? Sigurisht që jo. I gjithë uji do të vazhdojë të rrjedhë derisa tullumbacia të boshatiset . Kjo ndodh me të gjitha lëngjet në hapësirat e mbyllura.

Gjaku lëviz përmes një rrjeti të mbyllur venash dhe fillon të dalë jashtë edhe në rastin e një prerjeje të lehtë. Megjithatë, për shëndetin tonë është mjaft e rëndësishme që ai të ndalojë



rrjedhjen. Ju mund të keni dëgjuar për njerëz që vdesin nga humbje të mëdha gjaku në aksidente ose operacione. Po, atëherë, çfarë e bën gjakun të ndalojë rrjedhjen vetëm pak kohë pasi plaga fillon të rrjedhë?

Kjo quhet mpiksje e gjakut, e cila është një nga sistemet automatike të sigurisë në trupin tonë. Disa substanca që gjenden në gjak ndalojnë rrjedhjen e tij dhe mbyllin plagën. Falë aftësisë së mpiksjes së gjakut, ndalohet rrjedhja e tepërt e tij. Siç tregohet edhe në ilustrimin në të djathtë, disa qeliza në gjak lajmërohen për venën e dëmtuar dhe nisen menjëherë në këtë vend. Fillimisht ato rreshtohen përreth plagës dhe



Gjaku rrjedh nga plaga.



Gjaku që rrethon plagën mpikset.



Qelizat e mbyllin plagën njëloj si me tapë

Një gërvishtje në dorë apo një plagë në gju shërohet për një kohë të shkurtër. Piktura më sipër tregon diçka rreth asaj çka ndodh në gjak gjatë procesit të shërimit.




pengojnë rrjedhën e gjakut duke thurur një rrjetë. Kjo rrjetë ngurtësohet me kalimin e kohës dhe formon atë që ne e quajmë shenjë të plagës.

Tani le të mendojmë së bashku. A ka mundësi që këto seri veprimesh të planifikuara të veprojnë rastësisht? Si ka mundësi që disa qeliza gjaku të njoftohen për një dëmtim diku në enët e gjakut, të cilat janë si një botë gjigante në krahasim me përmasat e tyre. Përse luftojnë ato për të ndaluar rrjedhjen e gjakut? Nga e dinë ato që duhet të mbyllin plagën në mënyrë që të ndalojnë humbjet e gjakut? Kush i mësoi këto qeliza që ato duhet ta mbyllin plagën?

Nuk ka mundësi që qelizat t'i kenë mësuar gjithë këto gjëra rastësisht, por, as kanë mundësi t'i përmbushin këto detyra vetë në





Në figurën më lart, ju mund të shihni qelizat e kuqe të gjakut të ngecura midis fibrave të një tromboze gjaku. Në sajë të aftësisë mpikëse të tij, gjaku vazhdon të rrjedhë vetëm për shumë pak kohë pasi jeni dëmtuar.

sajë të aftësisë së tyre. Madje, edhe qeniet njerëzore, të cilat janë të pajisur me inteligjencë, nëse i jepet e drejta, nuk mund të krijojnë një sistem të tillë kaq të detajuar dhe t'u mësojnë qelizave se çfarë duhet të bëjnë. Patjetër, inteligjenca që paraqesin këto qeliza nuk u përket atyre. Është Allahu që i udhëzon ato dhe ato veprojnë sipas një plani të pashoq.

Allahu na njofton për përsosmërinë e krijimit të Tij si më poshtë:

Ai është që krijoi shtatë qiej në shtresa. Në krijimin e Mëshiruesit nuk mund të shohësh ndonjë të metë, andaj, drejto shikimin, a sheh ndonjë çarje? Mandej herë pas here drejto shikimin, e shikimi do të kthehet tek ti i përulur dhe i molisur! (Sure El-Mulk: 3-4)

GJAKU: NJË LËNG I MREKULLUESHËM, I PAARRITSHËM PËR T'U IMITUAR

Shkencëtarët kanë kryer mjaft studime në mënyrë që të arrijnë të prodhojnë një lëng të ngjashëm me gjakun. Megjithatë, duke dështuar në arritjen e një qëllimi të tillë, ata hoqën dorë nga përpjekja për të imituar gjakun dhe i përqendruan kërkimet e tyre në fusha të tjera.

Shkencëtarët nuk mund ta imitojnë gjakun për arsye se kampionët e gjakut të marra nga një enë gjaku mpiksen menjëherë dhe struktura e gjakut bëhet e papërshtatshme për studim. Por, edhe ruajtja e kampioneve në epruveta qelqi përsëri nuk jep rezultat, për arsye se qelizat e gjakut nuk mbijetojnë plotësisht në epruveta. Si rrjedhim, shkencëtarëve u duhej t'i veçonin qelizat e gjakut dhe t'i studionin ato në mënyrë të veçantë. Padyshim, një nga shpjegimet më të paarsyeshme dhe jologjike në botë është të pretendosh që një substancë e tillë e paarritshme, e cila edhe as nuk mund të imitohet me të gjithë informacionin e mbledhur nga njerëzimi për vite me radhë, të ketë ardhur në jetë spontanisht dhe në mënyrë të rastësishme. Allahu e krijoi gjakun si një substancë të pakonkurrueshme. Një qelizë gjaku, e cila ka aftësi të mahnitshme është thjesht një nga shfaqjet e diturisë së pakufishme të Allahut në trupin e njeriut.



MOTORI I TRUPIT: ZEMRA

A keni menduar ndonjëherë se sa litra gjak qarkullojnë lart e poshtë pa pushim në trupin tonë? Për të kryer një lëvizje të vazhdueshme çdo objekt ka nevojë për një motor. Makinat, aeroplanët, motoskafët, madje edhe makinat lodër me telekomandë lëvizin me ndihmën e një motori. Në mënyrë të ngjashme, edhe gjaku që qarkullon në trupin tonë ka nevojë gjithashtu për një motor. Motori që vë në lëvizje gjakun tonë ditë e natë, për muaj madje, për vite me radhë, është zemra jonë.

Vendosni gishtat tek kyçi i dorës dhe prisni pak. Do të ndjeni rrahjen e zemrës tuaj. Zemra bën 70 rrahje në minutë, dhe gjatë gjithë jetës tuaj pompon afërsisht 152 milion litra gjak. Kjo sasi e madhe gjaku është afërsisht e barabartë me sasinë e naftës që mbajnë 10 000 fuçi naftë. Këto të dhëna janë befasuese, apo jo? Tani imagjinoni që ju duhet të zbrazni një kovë me ujë dhe ta kaloni atë në një tjetër me anë të një gote, 70 herë në minutë. Në fund të kësaj detyre muskujt e krahut dhe dorës tuaj do t'ju dhembnin dhe do t'ju duhej të pushonit. Megjithatë, zemra juaj e kryen këtë detyrë përgjatë gjithë jetës tuaj dhe nuk pushon kurrë gjatë kësaj kohe.



POMPA MË E PËRKRYSER

Zemra, e cila është një organ muskolor me përmasat e një grushti dore, është e përbërë nga dy pjesë. Në secilën nga këto pjesë ka nga një pompë. Pompa e majtë, e cila është më e fortë, dërgon gjak të pasur me oksigjen në të gjitha pjesët e trupit. Pompa e djathtë është më e dobët se e para dhe dërgon gjak të varfër me oksigjen në mushkëri. Transporti i gjakut nga zemra për në mushkëri përkrahon një distancë të shkurtër prandaj edhe quhet "qarkullimi i vogël". Ndërsa i pari quhet "qarkullimi i madh".

Secila nga gjysmat e zemrës ndahet më tej në dy ndarje të tjera. Gjaku kalon nga njëra ndarje tek tjetra përmes valvulave të zemrës. Këto pompa punojnë pa ndërprerë me një sasi të madhe energjie, falë së cilave gjaku qarkullon në trupin tonë 1,000 herë në ditë.


Zemra juaj është një muskul mjaft i fortë. Ajo rreh rreth 70 herë në minutë dhe pompon 59 cm³ gjak në çdo rrahje. Zemra kryen 2 500 000 rrahje në 70 vjet dhe gjatë kësaj kohe ajo pompon rreth 152 000 000 litra gjak. Një sasi e tillë gjaku është afërsisht ekuivalente me sasinë e karburantit që mbush serbatorët e 10 avionëve reaktivë Boeing 747 gjatë një viti.



Serbatori i një avioni reaktiv kur mbushet plot mban 217 000 litra karburant



Pompat origjinale të zemrës



Zemra, e cila është një organ muskolor me përmasat e një grushti dore, është e përbërë nga dy pjesë. Në secilën nga këto pjesë ka nga një pompë. Pompa e majtë, e cila është më e fortë, dërgon gjak të pasur me oksigjen në të gjitha pjesët e trupit. Pompa e

djathtë është më e dobët se e para dhe dërgon gjak të varfër me oksigjen në mushkëri. Transporti i gjakut nga zemra për në mushkëri përshkon një distancë të shkurtër prandaj edhe quhet "qarkullimi i vogël". Ndërsa i pari quhet "qarkullimi i madh".

Secila nga gjysmat e zemrës ndahet më tej në dy ndarje të tjera. Gjaku kalon nga njëra ndarje tek tjetra përmes valvulave të zemrës. Këto pompa punojnë pa ndërprerë me një sasi të madhe energjie, falë së cilave gjaku qarkullon në trupin tonë 1,000 herë në ditë.




Zemra mirëmban veten e saj

Makineritë kanë nevojë për mirëmbajtje të vazhdueshme. Mund të jetë e nevojshme që disa pjesë të makinës të mirëmbahen, ose të zëvendësohen ato pjesë që janë prishur. Makineritë kanë nevojë të trajtohen me vaj pas një periudhe kohe pune, në mënyrë që të zvogëlohet dëmtimi i tyre për shkak të fërkimit.

Po ashtu si makineritë, edhe zemra, e cila punon vazhdimisht gjatë gjithë kohës, ka gjithashtu nevojë për mirëmbajtje. Megjithatë, ajo e kryen vetë mirëmbajtjen e saj, ajo vetë-lubrifikohet.

Po si e kryen zemra vetë-lubrifikimin e saj? Përgjigjia e kësaj pyetje fshihet në krijimin e zemrës. Sipërfaqja e jashtme e zemrës mbulohet nga një qese që përbëhet nga dy membrana. Midis këtyre membranave ndodhet një lëng i yndyrshëm. Ky lëng vepron ngjashëm me vajin e motorrit dhe lehtëson punën e zemrës. Kjo strukturë vetëmbrojtëse e zemrës shpalos edhe njëherë se sa e përsosur dhe e plotë është mjeshtëria e Allahut në krijim.

SKELETI I PËRBËRË NGA KOCKAT



N

ë trupin tonë gjenden 206 kocka. Ju mund të mendoni se të gjitha këto janë shumë, por, me shembullin që do të japim, do të kuptoni se sa e rëndësishme është qenia e kaq shumë kockave. Le të marrim e të shqyrtojmë gishtërinjtë. Nëse secili nga gishtërinjtë tuaj do të përbëhej vetëm nga një kockë e njëtrajtshme, ju nuk do të ishit në gjendje ta mbanit këtë libër ashtu siç jeni duke bërë tani. Kjo për arsye se, një kockë e njëtrajtshme nuk mund të përthyeret dhe mund të thyhet nëse e sforconi atë shumë fort. Përderisa ju nuk do të ishit në gjendje të përthyenit gishtërinjtë tuaj, nuk do të ishit në gjendje as të kapnit apo të shtrëngonit sendet. Ju nuk do të ishit në gjendje as të shkruanit dhe as të hanit. Ajo që ju mundëson juve të mbani me lehtësi këtë libër dhe ndoshta të pinin në të njëjtën kohë lëngun e frutave, është prania e 27 kockave të ndërlidhura në dorën tuaj, duke përfshirë edhe ato të gishtërinjve.



Siç thamë edhe më parë, në trupin tonë gjenden 206 kocka, të cilat janë të lidhura me njëra-tjetrën ngjashëm me ato të duarve. Secila nga këto kocka është vendosur në vendin e vet sipas një plani inteligjent. Në sajë të këtij plani të pashembullt, ju arrini të përkulni para trupin tuaj, të bini në gjunjë dhe të ktheni kokën anash.

Por mos bëni gabim: nuk i bëni të gjitha këto gjëra vetëm me përdorimin e kockave tuaja, kockat nuk mund të përthyhen. Në pikat e lidhjeve të kockave tuaja ka nyje. Falë këtyre nyjeve, ju mund të përthyeri me lehtësi krahun tuaj, të ngrini këmbën dhe të përdorni gishtërinjtë.



Le të japim një shembull në mënyrë që t'ju ndihmojmë juve ta kuptoni më mirë se sa të rëndësishme janë nyjet për lëvizjen e kockave tona:

Le të supozojmë që ju keni ndërtuar një kukull prej druri. Çfarë do të bënit ju që të lëviznit





krahët e saj? Krahët e kukullës sigurisht që nuk do të lëvizin në qoftë se ju nuk do të vendosnit një nyje në vendbashkimin e krahut me supin. Po këmbët e saj si do t'i bënit të lëvizshme? Ju përsëri duhet të përdorni nyje në vendbashkimin e këmbëve me trungun e saj. Vetëm pasi të keni bërë këto ju mundeni të lëvizni krahët dhe këmbët e kukullës së drurit. Po ashtu, nëse e ndani drurin që e

keni përdorur për krahët dhe këmbët në dy pjesë dhe vendosni nyje ndërmjet këtyre pjesëve, atëherë krahët dhe këmbët e kukullës do të ishin gjithashtu të përthyeshme tek bërrylat dhe gjunjët.

Siç mund të kuptohet qartë nga ky shembull, pasja e shumë kockave dhe nyjeve të vendosura midis tyre atje ku është e nevojshme, na bën të mundur lëvizjen me lehtësi.



nyje kokë me shtrat
rrotullues

nyje mbështetëse

nyje menteshë

nyje kokë dhe fole




CILËSITË E PAIMITUESHME

Kockat tona i bashkojnë tipe të ndryshme nyjesh. Disa nga këto nyje u mundësojnë kockave të lëvizin para dhe mbrapa, të tjera u mundësojnë atyre të lëvizin anash. Tani le t'i shohim nyjet dhe kockat pak më nga afër.

Kockat tona kanë marrë përsipër detyrën e mbajtjes dhe mbrojtjes së trupit tonë. Sigurisht, që ato janë krijuar të afta dhe të forta sa duhet, për të kryer këto detyra të vështira.

Kockat tona janë të lehta për arsye se ato janë pajisur me vrimëza të vogla ngjashëm me hojet e bletëve. Por, megjithëse janë shumë të lehta falë strukturës poroze të tyre, ato janë gjithashtu edhe shumë të paepura. Megjithatë, kjo nuk do të thotë që ato janë të thyeshme. Përkundrazi,



Kulla Eifel



TË KOCKAVE

ato janë aq të paepura saqë po të marrim të njëjtën sasi kockash dhe hekuri, ato janë 5 herë më të forta se hekuri. Për

shembull, kockat e kofshës

kanë një aftësi aq të

madhe saqë kur

qëndrojnë në

pozicionin vertikal ato

mund të ngrenë një ton

ngarkesë. Kur kërceni

nga njëra anë në tjetrën, kjo

kockë i nënshtrohet peshave deri

në 3-4 herë më të mëdha se ajo e

trupit tuaj. Megjithatë, ju nuk

pësoni ndonjë dëmtim, për

shkak të qëndrueshmërisë dhe

fortësisë së kockave tuaja.

Çfarë i bën kockat

kaq të forta? Në fakt,

përgjigjja e kësaj

pyetje fshihet në

krijimin e

Kjo strukturë poroze, e cila shpjegon edhe qëndrueshmërinë e kockave, zbatohet gjithashtu edhe në ndërtimin e ndërtesave të forta. Struktura e brendshme e kockave ka shërbyer si model për ndërtimin e shumë ndërtesave të njohura. Kulla Eifel është njëra prej tyre.





KAFKA: MBUROJA E TRURIT

Përveçse mburojë e trurit, kafka mundëson lidhjen e syve, veshëve, hundës dhe gojës. Edhe pse duket një strukturë e thjeshtë, kafka është pjesa më e gjithanshme e skeletit. Në të janë 22 kocka të lidhura me njëra tjetrën.

pakrahasueshëm të kockave, të cilin e kemi përmendur shkurtimisht më lart. Kockat janë të përbëra nga një material poroz ngjashëm me hojet e bletëve. Falë këtij ndërtimi ato janë, jo vetëm mjaft të forta, por, edhe të lehta për t'u përdorur në detyrën që ato kanë. Në qoftë se do të kishte qenë ndryshe, domethënë, nëqoftëse brendësia e kockave do të kishte qenë e ngurtë dhe nuk do të përbëhej nga hapësira, dhe të kishin qenë ashtu siç është pjesa e jashtme e tyre, kockat do të kishin qenë shumë të rënda. Veç kësaj, përderisa ato nuk do të ishin fare elastike, kockat tuaja do të thyheshin ose kriseshin me goditjen më të thjeshtë, le të themi kur krahu juaj do të përplasej lehtë me cepin e një komode. Mirëpo, Allahu është i Gjithëmëshirshëm dhe Ai i krijoi kockat tona në mënyrë të tillë që të sigurojnë lehtësi dhe mbrojtje fizike për ne.

Përbërja e kockave ka ngjallur mjaft interes tek shkencëtarët, ndaj ata janë përpjekur për vite me radhë që të imitojnë indin e tyre. Ky ind, i cili është shumë i fortë, duke qenë edhe mjaft i lehtë dhe i cili, ç'është më e rëndësishmja, është i aftë të riparojë vetveten, mund të

Që kur keni lindur, të gjitha kockat tuaja janë rritur dhe zgjatur në një raport mjaft të përkryer. Falë këtij raporti kaq të mirë të zgjatjes së kockave tona, ne bëhemi më të gjatë kur rritemi më tepër në moshë.



rritet vetë. Arsyeja që gjatësia e juaj e tanishme nuk është e njëjtë me gjatësinë në moshën 4-5 vjeç dhe arsyeja që gjatësia juaj do të jetë e ndryshme kur të arrini moshën 19-20 vjeç vjen për shkak të rritjes së kockave tuaja.

Në mënyrë shumë të mahnitshme kjo rritje është harmonizuar mjaft mirë. Krahët tuaj rriten ndërsa edhe këmbët tuaja rriten, gishtërinjtë e dorës dhe ato të këmbëve rriten në mënyrë harmonike dhe rritja e çdo kocke ndalon në një kohë të caktuar. Veç kësaj, kjo gjë nuk ndodh vetëm në trupin tuaj, por, në trupin e çdo njeriu të shëndetshëm. Çdo njeri ka kocka që i kanë këto karakteristika. Shkencëtarët kanë ndërmarrë studime që të arrijnë të prodhojnë një substancë të ngjashme me atë që formon kockat në trupin e njeriut. Megjithatë, asnjë nuk ka arritur të prodhojë një substancë me karakteristika të tilla të përparuara si kocka.


Falë mëshirës së Zotit tonë, kockat na mundësojnë neve jetë të lehtë dhe gjithashtu të kryejmë një shumëllojshmëri të madhe lëvizjesh pa asnjë vështirësi dhe pa asnjë mundim.



KOCKAT MIRËMBAJNË VETVETEN

Kemi shpjeguar se, në vendbashkimin e kockave me njëra tjetrën ka nyje. Për shembull, ne mund të përthyejmë dhe shtrijmë krahët dhe këmbët tona falë nyjeve të vendosura tek bërrylat dhe gjunjët tanë. Megjithëse këto nyje lëvizin gjatë gjithë jetës sonë, ato nuk kanë nevojë të lubrifikohen. Megjithatë, makineritë, kanë nevojë për mirëmbajtje të vazhdueshme. Për shembull, juve ju duhet të lubrifikoni pedalet ose zinxhirin e biçikletës herë pas

Nyjet ju mundësojnë të përkulni me lehtësi gishtat tuaj. Ndërmjet tyre ekziston një projektim i veçantë për të penguar fërkimin, dhe, si rrjedhim, edhe konsumimin, gërvishtjen dhe dhimbjen.



here për arsye se sasia e vajit të tyre pakësohet gjatë përdorimit, dhe kjo gjë pengon lëvizjen. Në të njëjtën mënyrë, edhe nyjet ndërmjet kockave tuaja përdoren gjatë gjithë kohës, por, megjithatë ju nuk keni nevojë asnjëherë t'i lubrifikoni ato. Po përse ndodh kjo?



Shkencëtarët e kanë kërkuar gjatë përgjigjen e kësaj pyetjeje, dhe më në fund zbuluan faktin e mëposhtëm: në një nyje, një material i fortë si gomë i quajtur jastëku kërcor formon fundet e kockave në pikat e takimit. Një membranë e hollë e cila shtrihet në të gjithë kavitetin e nyjes sekreton një lëng të veçantë. Kur kocka ushtron forcë mbi nyje, ky lëng detyrohet të dalë jashtë membranës dhe kështu nyja “lubrifikohet”.

Të gjitha këto fakte tregojnë që trupi i njeriut është rezultat i një projektimi të përkryer dhe krijimi të mrekullueshëm. Vetëm në sajë të këtij projektimi të pashembullt, ne arrijmë të bëjmë shumë lëvizje të ndryshme shpejt dhe me lehtësi. Këto veti të kockave janë krijuar nga Zoti ynë. Allahu i fton njerëzit të mendojnë rreth krijimit të kockave:

... Dhe shikoji kockat - se si Ne i kombinojmë ato dhe i veshim me mish... (Sure Bekare: 259)



1



një masë e madhe gjaku e mpiksuar rrethon kockën e thyer



një ind i ri kërcor shfaqet në zonën e thyer

2

SI SHËROHET NJË KOCKË E THYER?

Përmendëm më lart se kockat janë shumë të ngurta dhe të forta. Megjithatë, ato mund të thyhen në qoftë se pësojnë goditjeve të rënda. Po çfarë ndodh atëherë? Kocka riparon vetveten. Doktorët e ngjitin kockën e thyer dhe e fusin atë në allçi në mënyrë që pjesa e thyer të përputhet siç duhet. Më pas, doktorëve nuk u mbetet gjë tjetër për të bërë sepse kocka ka mekanizmin e saj vetëriparues. Është mrekulli që një kockë e thyer shërohet vetë dhe bëhet madje edhe më e fortë se më parë. Kjo mrekulli ndodh si më poshtë:

Gjaku që rrethon kockën e thyer mpikset dhe formon një "hematomë", e cila është një masë e madhe gjaku e mpiksuar. Kjo masë gjaku e mpiksuar është një veshje e



4



indi i ri kockor vjen në formën e duhur në pak muaj



formohet ind i ri kockor

3



Duke vepruar me një mjeshtri prej skulptori, qelizat tona asnjëherë nuk e tejkalojnë duke shkaktuar efekte të dëmshme. Ato nuk bëjnë gabim në formësimin dhe zgjatimin e kockave tona. Veç kësaj, ato llogarisin pa asnjë gabim se kur duhet të shumohen dhe kur duhet të ndalojnë. Mendoni për një moment - po sikur kockat e gishtërinjve tuaj të rriteshin vazhdimisht apo këmbët tuaja të zgjateshin e të zgjateshin? Kjo do të ishte shumë tmerruese, apo jo? Por kjo nuk ndodh kurrë dhe të gjitha kockat tuaja zgjaten saktësisht aq sa duhet. Kjo është një nga provat e qarta për faktin që qelizat tona veprojnë me frymëzimin e Allahut.

ngjashme me koren që zë lëkura kur pritet. Mineralet që sekretohen nga qelizat ndërtuese të kockave e transformojnë këtë masë gjaku të mpiksur në një kockë të ngurtë. Pasi mbaron kjo fazë, hyjnë në veprim qelizat gërryese të kockave. Duke vepruar si skulptore profesioniste, këto qeliza e pakësojnë kockën e re duke përdorur acid klorhidrik, i cili është një acid shumë i fortë, për t'i dhënë kështu kockës një formë të veçantë. Ky proces vazhdon deri sa kocka rifiton formën e saj të mëparshme. Qelizat gërryese të kockave vazhdojnë ta reduktojnë kockën, madje edhe deri pas një viti, si skulptore të zellshme në mënyrë që t'i japin formë.





Kockat e gishtave të këmbëve janë të ndryshme nga ato të gishtërinjve të duarve tuaja. Gjatësitë, format, dhe trashësia e tyre ndryshojnë nga njëri-tjetri. Megjithëse, siç edhe mund t'ju kujtohet, të gjitha ato prodhohen nga të njëjtat qelizat kockore.



Siç mund ta keni kuptuar, të gjitha këto detyra që kryhen nga qelizat kockore, të cilat janë shumë të vogla për t'u parë me sy të lirë, janë shenja të një diturie të lartë. Kjo, për arsye se qelizat nuk kanë sy që të shikojnë me to dhe pavarësisht nga kjo, ato mund të ndërtojnë kocka. Përveç kësaj, ato mund të kuptojnë kohën kur hapësira midis dy pjesëve të thyera mbushet dhe kështu vendosin se kur të ndalojnë. Qelizat gërryese të kockave vënë re që kocka e saponjërtuar ka nevojë t'i jepet formë, dhe fillojnë ta gërryejnë atë. Në mënyrë që ta bëjnë këtë, ato përdorin një acid të fortë për të gërryer kockën, dhe i japin asaj formën e duhur duke e përdorur këtë acid në sasi të vogla e të mëdha ashtu siç është e nevojshme.

Siç mund ta shikoni, të gjitha qelizat e kockave e dinë shumë mirë se çfarë të

bëjnë, “si” dhe “kur” ta bëjnë. Sistemi i ndërtuar për shërimin e kockave tona punon në një mënyrë të përkryer dhe u mundëson atyre të riparojnë vetveten. Shkencëtarët i kanë admiruar këto aftësi mahnitëse të kockave për vite me radhë.



Si arritën qelizat e kockave të fitojnë një aftësi të tillë mahnitëse, e cila funksionon madje tërësisht pa vetëdijen e njeriut? Si arrijnë qelizat të dinë se çfarë u duhet për të riparuar një kockë të thyer dhe çfarë veprimesh të kryejnë në mënyrë që ta shërojnë atë? Ndërsa disa nga qelizat kanë fituar aftësinë e ndërtimit të kockave, të tjerat kanë marrë përsipër detyrën e dhënies formë të tyre. Kush ua caktoi atyre këto detyra? Si ndodh që nuk ka asnjë çrregullim dhe si shpjegohet që secila prej tyre e kryen detyrën e saj pikërisht në momentin e duhur kur kërkohet? A i mësuan vetë qelizat e kockave të gjitha këto gjëra?

Pa dyshim që, të gjitha këto detyra të jashtëzakonshme nuk mund të bëhen me vetë vullnetin e këtyre qelizave që janë pothuajse të padukshme. Ato nuk mund t'i kenë mësuar këto detyra rastësisht. Duke vepruar me frymëzimin e Allahut të Gjithëditur, i Cili i krijoi ato, qelizat tona të kockave arrijnë t'u japin formë kockave tona si mjeshtre skulptore.




A e keni pyetur ndonjëherë veten si qelizat e trupit i formojnë kockat?

Shumica e formave të 206 kockave që gjenden në trupin tonë janë të ndryshme nga njëra-tjetra. Ky dallim ndërmjet tyre filloi që kur ato u shfaqën për herë të parë, pra, kur ishit në barkun e nënës suaj. Qelizat, të cilat gradualisht po rriteshin në numër, morën forma të ndryshme sikur secilës prej tyre t'i ishte mësuar se cilën pjesë të trupit i duhej të ndërtonin.

Disa nga qelizat u ndanë për të krijuar kockat, disa për të formuar mëlçinë, disa për të formuar veshkat dhe disa të tjera për të formuar sytë. Por, grupet e qelizave që do të formojnë mëlçinë, kockat apo sytë nuk bashkohen përkatësisht thjesht me njëra tjetrën dhe kaq. Ato kanë nevojë të ndahen akoma më tej.







Hapësirat midis kockave të kafkës së një foshnje zhduken me kalimin e kohës duke u rritur kockat.

Për shembull, qelizat e kockave duhet të jenë të vetëdijshme për vendndodhjen e kockës që ato do të formojnë në trup. Më pas, ato duhet të shkojnë secila në vendin e duhur dhe të marrin formën e duhur.

Qelizat e kockave në këmbët tuaja veprojnë si skulptore profesioniste dhe formojnë kockat e këmbëve të gdhendura në mënyrë të përkryer, me pjesët e dala dhe të futura për gishtërinjtë që gjenden në to. Qelizat e kockave që formojnë kafkën tuaj ndërtojnë përmasën e trurit sikur ta dinin, një skelet kockor të lëmuar që mbyll brenda trurin në mënyrë të përsosur. Kafka nuk është as e vogël, por, as shumë e madhe, kështu që ajo as nuk e shtyp trurin por, as nuk ua vështirëson juve mbajtjen drejt dhe lart të kokës.





faza më e hershme e kockës së një fëmije në barkun e nënës

stad i avancuar i kockës së një fëmije në barkun e nënës.

kocka e një fëmije

Një fëmijë, kur ndodhet ende në barkun e nënës, është më së shumti i përbërë nga kërci. Kërci zhvillohet dhe shndërrohet me kalimin e kohës në kocka të forta, siç shikohet edhe në diagramin e mësipërm.



Ashtu si të gjitha kockat e trupit, edhe kockat e gishtërinqe, zhvillohen me rritjen në moshë. Sidoqoftë, ajo që ia vlen të theksohet këtu është se, secili nga gishtërinjtë rritet në mënyrë proporcionale në lidhje me tjetrin.

Cili është burimi i vetëdijes së qelizave, të cilat u japin formë të përkryer kockave, duke ditur se cilën formë ato duhet të marrin dhe cilin ind ato duhet të ndërtojnë?

Zoti ynë është Ai, i Cili ia frymëzon këtë plan delikat atyre. Dituria e lartë e Allahut shfaqetet në ajetin e mëposhtëm:

E Tij është çka në qiej e në tokë dhe të gjithë vetëm Atij i përulen. Dhe Ai është që e shpik jetën dhe pastaj e përsërit atë, e ajo është më e lehtë për Të. Shëmbëlltyra më e lartë është vetëm e Tij në qiej e në tokë dhe Ai është Mbizotëruesi, i Gjithëdituri. (Suretu Er-Rrum: 26-27)



MOTORËT MIKROSKOPIKË TË TRUPIT: MUSKUJT

Muskujt janë stacionet e fuqisë së trupit tonë. Ata kanë përsipër detyrën e transformimit të energjisë në fuqi, të cilën ato e kryejnë në mënyrë të përsosur gjatë gjithë jetës së njeriut. Ne këtë e vëmë re ndonjëherë, por, shumicën e kohës nuk jemi të vetëdijshëm për një gjë të tillë. Për shembull, disa muskuj tkurren, megjithëse, ne nuk bëjmë ndonjë përpjekje të ndërgjegjshme. Të këtij lloji janë muskujt e zemrës dhe të stomakut. Veprimi i tyre është jashtë kontrollit tonë.

Muskujt që tkurren me vullnetin tonë janë ata që i janë bashkangjitur skeletit. Trupi i njeriut përmban 650 muskuj të vullnetshëm. Kur lëvizim, këta muskuj tkurren dhe çlodhen së bashku me kockat të cilave iu janë bashkangjitur.

Muskujt vihen në lëvizje nga enët e gjakut dhe nervat. Enët e gjakut bëjnë transportimin e oksigjenit dhe ushqimit në muskuj, ndërsa nervat kontrollojnë lëvizjen e tyre.



Zemra juaj punon në mënyrë të pandërprerë. Ju, madje, nuk e çoni nëpër mend fare nëse ajo po punon apo jo kur jeni duke fjetur.

Çfarë do të ndodhte nëse kontrolli i muskujve do t'u lihej krejtësisht juve në dorë? Për shembull, imagjinoni që tani e tutje muskujt e zemrës tuaj do të tkurren vetëm me anë të kontrollit tuaj të ndërgjegjshëm. Ju nuk do të bënit gjë tjetër, veçse do të përqendroheshit në tkurrjen dhe çlodhjen e muskujve të zemrës tuaj. Kjo për arsye se, nëse muskujt e zemrës tuaj nuk do të kontraktroheshin madje edhe për një moment, ju do të vdisnit.

Dhe kur t'ju merrte gjumi, vdekja do të ishte e pashmangshme, përderisa ju nuk do të ishit në gjendje të kontrollonit punën e zemrës tuaj. Mirëpo, kjo nuk ndodh

asnjëherë, pasi juve nuk ju

duhet të mendoni për gjëra të tilla, falë sistemit të përkryer të kontrollit që gjendet në trupin tuaj.



Ajo çka duhet të bëjmë, mbi të gjitha, është që ta falënderojmë Zotin tonë të Mëshirshëm, i Cili na e ka lehtësuar çdo gjë, dhe të sillemi në atë mënyrë me të cilën Ai është i kënaqur. Allahu na urdhëron ta adhurojmë vetëm Atë në ajetin e mëposhtëm:

Ky është Allahu, Zoti juaj nuk ka të adhuruar veç Tij, Krijuesi i çdo sendi, pra adhurojeni Atë. Ai është mbikëqyrës ndaj çdo sendi. (Sure El-En'am: 102)

Muskujt punojnë në mënyrë harmonike

A e dini se, kur qeshni në fytyrën tuaj tkurren në mënyrë të harmonishme 17 muskuj? Nëse ndonjëri nga këta muskuj nuk do të tkurrej apo nuk do të punonte, ju nuk do të ishit në gjendje të buzëqeshnit. Veç kësaj, ju do të mbeteshit me një shprehje boshe në fytyrën tuaj.

28 muskuj kontrollojnë shprehjen e fytyrës tuaj. Me tkurrjen e përbashkët të këtyre muskujve, ju mund të përftoni qindra mënyra shprehjeje të ndryshme. Në sajë të këtyre muskujve, ju mund të shprehni zemërim, hutim, gëzim, kënaqësi dhe shumë emocione të tjera. Përveç muskujve të fytyrës, në trupin tuaj punojnë në harmoni edhe muskuj të tjerë. Për shembull, për të hedhur një hap të vetëm, hyjnë në veprim njëkohësisht 54 muskuj.



Me anë të tkurrjes së përbashkët të muskujve të fytyrës, fytyra juaj mund të marrë shprehje të ngjashme me këto që shikoni këtu më lart.

Në këtë mënyrë, ne mund të kryejmë me lehtësi qindra lëvizje, të cilat na duken të zakonshme. Por, pasi të keni lexuar gjithë këtë, duhet të ndaleni dhe të mendoni, për arsye se ai nuk ndihmon asgjë në punën e këtyre muskujve. Nëse muskujt nuk do të punonin siç duhet, nuk do të ishte e mundur të hidhej një hap i vetëm, e jo më të vrapohej, të notohej apo të ngitej një biçikletë. Si rrjedhim, ne duhet të ngulisim një të vërtetë të rëndësishme në mendjen tonë: Allahu ka krijuar një sistem të përkryer në trupin e njeriut. Kjo është një dhuratë nga Zoti ynë. Ajo çka na takon të bëjmë është të meditojmë mbi mëshirën e pafundme të Allahut, të përkujtojmë madhështinë e Tij dhe ta falënderojmë Atë.



Duart kryejnë çdo gjë me mjeshtëri

Shfletimi i faqeve të një libri, hapja e derës së makinës, larja e duarve... Këto janë vetëm pak nga gjërat që ne kryejmë shpesh me duart tona, pa hasur asnjë vështirësi. Ne i përdorim duart tona për të kryer, gjithashtu, qindra veprime të tjera.


Dora e njeriut është aq e fortë saqë, mund të ushtrojë një presion prej 45 kg mbi një objekt madje edhe pa u mbledhur grusht. Pavarësisht nga një forcë e tillë, ne mund t'i përdorim duart tona edhe në veprime shumë delikate dhe të imta, si qepja me gjilpërë, sa herë që dëshirojmë një gjë të tillë. Ndërsa një grup veprimesh kërkojnë shumë forcë, të tjera veprime kërkojnë saktësi të madhe. Megjithatë, ne madje nuk arrijmë ta marrim me mend se sa të mrekullueshme janë veprat që sjellin duart tona në të vërtetë. Ne asnjëherë nuk vendosim në mënyrë të vetëdijshme të ushtrojmë një forcë prej 500 gramësh për të ngritur një copë letër nga tavolina apo të ushtrojmë një forcë prej 5 kg që të gjuajmë një top. Ne i kryejmë të gjitha këto gjëra automatikisht



pa menduar në mënyrë të vetëdijshme, pasi Allahu na krijoi në mënyrë të përkryer. Aftësia e mrekullueshme e duarve tona është rezultat i krijimit të pashoq të Allahut.

A e dini që shkencëtarët kanë bërë përpjekje të mëdha për të bërë një dorë artificiale, të ngjashme me atë të njeriut? Duart e robotëve të ndërtuara deri më tani kanë qenë të barasvlershme me dorën e njeriut vetëm për sa i përket forcës, por nuk është mundur të realizohet shqisa e të prekurit dhe as aftësia e kryerjes së disa detyrave të ndryshme në të njëjtën kohë.

Të themi të vërtetën, mendimi i shumë shkencëtarëve është se, nuk mund të ndërtohet një dorë roboti që të ketë të gjitha funksionet e dorës së njeriut. Inxhinieri që ka projektuar dorën e robotit të njohur si “Dora Karlsruhe” Hans J. Schneebeli ka thënë





Ju mund të kryeni lirisht çfarë të dëshironi duke përdorur duart tuaja. Mund të shkruani, të hani ushqim, të lani fytyrën, të mbani një top, e kështu me radhë. Veç kësaj, ju i kryeni të gjitha këto gjëra pa hasur asnjë vështirësi. Megjithatë, duart artificiale, të cilat shkencëtarët dhe teknikët i kanë prodhuar pas shumë vitesh studimi, mund të kryejnë vetëm një numër të kufizuar detyrash.

se, sa më shumë që ai punon në projektimin dhe realizimin e duarve robotike aq më shumë ai e admiron dorën njerëzore. Ai shton se, atyre u duhet akoma shumë kohë që të jenë në gjendje të realizojnë vetëm pak nga punët që është në gjendje të kryejë dora e njeriut.

Duart tona, të cilat nuk mund të imitohen madje as nga teknologjia bashkëkohore, janë projektuar nga Allahu. Ato shfaqin përsosmërinë në mjeshtërinë e krijimit të Allahut.

Nuk ka krijues tjetër veç Allahut. Në ajetin e mëposhtëm, Allahu na informon që nuk ka zot tjetër veç Tij dhe u drejtohet atyre që nuk e shohin këtë fakt:


Thujaj: "Kush është zoti i qiejve dhe i tokës?" Thujaj: "Allahu." Thujaj: " A keni pranuar veç tij zotëra, që nuk kanë mundësi t'i sjellin as dobi as dëm vetvetes?" Thujaj: "A është i barabartë i verbëri me atë që sheh, ose a janë të njëjta errësirat me dritën? A mos i kanë bërë Allahut shokë (idhuj) që krijojnë ashtu si Ai krijon dhe atyre u është bërë i ngjashëm krijimi? Thujaj: "Allahu është krijuesi i çdo sendi, Ai është i Vetëm, Nënshtruesi." (Sure Er Rr'ad: 16)



KONDITIONERI I AJRIT PUNON PA PUSHIM NË TRUPIN TONË


Frymëmarrja është një nga veprimet që ju kryeni në mënyrë të pavetëdijshe gjatë gjithë ditës. Gjatë këtij veprimi marrin pjesë shumë ndryshime të pandërprera, ku përfshihen hunda, laringu dhe mushkëritë. Në të vërtetë frymëmarrje do të thotë të furnizosh me oksigjen qelizat e trupit. Qelizat nuk mund të mbijetojnë në qoftë se nuk u sigurohet oksigjen. Kjo është arsyeja pse, ju nuk mund ta mbani frymëmarrjen vetëm se për një kohë të shkurtër. Nëse kjo kohë zgjatet, qelizat fillojnë të vdesin, gjë që shkakton vdekjen e trupit tuaj.

Ajri që thithni, fillimisht pastrohet në hundën tuaj. Hunda, e cila kryen ngrohjen e ajrit është e pajisur me qime të cilat veprojnë si një filtër. Këto qime e rregullojnë ajrin e ndotur ose të ftohtë për ta bërë atë të përshtatshëm për mushkëritë. Në sajë të këtyre qimeve, ajri që ne thithim filtrohet, pastrohet, pajiset me lagështi, ngrohet dhe



Qimëzat që shtrihen përgjatë hundës veprojnë si një kondicioner ajri, duke pas-truar dhe lagështuar ajrin që ne thithim.

Në këtë mënyrë trupi ynë mbrohet nga shumë mikrobe.



pastrohet nga bakteret e dëmshme. Me të vërtetë, këto qimëza të vogla e mbrojnë trupin tonë çdo ditë nga depërtimi i rreth 20 miliard pjesëza materialesh të huaja.

Njëzet miliard përbën afërsisht trefishin e popullsisë së tokës. Hunda është në dijeni të një procesi të tërë, falë të cilit ajo dallon kaq shumë pjesëza materialesh të huaja. Njëzet miliard pjesëza materialesh të huaja në asnjë mënyrë nuk mund të njihen dhe pengohen në hundë thjesht rastësisht. Kjo shpalos në mënyrë të qartë madhësinë krijuese të Allahut. Mirëpo, disa njerëz pohojnë që kjo ndodh rastësisht, megjithëse ata janë më se të






vetëdijshëm për të vërtetën. Njerëz të tillë, të cilët besojnë në teorinë e evolucionit, pohojnë që të gjitha qeniet e gjalla, përfshirë edhe çdo gjë çfarë ne kemi trajtuar deri më tani në këtë libër, kanë ardhur në ekzistencë vetvetiu dhe si rezultat i ngjarjeve të rastësishme që kanë ndodhur dikur në të kaluarën. A e dini pse e bëjnë këtë? Ato pohojnë kështu në mënyrë që të mohojnë ekzistencën e Allahut. Dhe për ta bërë këtë ata mendojnë se ka vetëm një mënyrë, e kjo është të pohosh që çdo gjë ndodh rastësisht. Mirëpo, duhet të mendosh vetëm pak, për të kuptuar se sa i pakuptimtë është ky pohim. Tani le të marrim në shqyrtim sistemin që punon në hundë, si një shembull për të hedhur poshtë këtë pohim.

Sistemi i kondicionimit në hundë është një pjesë tjetër e përkryer e trupit të njeriut. Sigurisht që një sistem i tillë i përkryer nuk mund të ketë ardhur në jetë si rezultat i rastësive. Bërja e një krahasimi do të na ndihmonte ta kuptonim më mirë këtë pamundësi. Le të shqyrtojmë një kondicioner ajri, i cili rregullon temperaturën në mënyrë që t'ju mbrojë nga nxehtësia në verë dhe t'ju ngrohë në dimër, dhe që komandohet në distancë. A mund të ketë ardhur në ekzistencë një sistem i tillë nga rastësia? Çfarë do të ndodhte nëse të gjitha pjesët e tij do të çmontoheshin dhe të lireshin ashtu? A do të bashkoheshin ato me kalimin e kohës dhe të shndërroheshin vetë në një kondicioner të kompletuar ajri?

Sigurisht që jo. Që të prodhohet një pajisje, duhet që një njeri inteligjent të punojë për të. Kjo është e padiskutueshme. Jo vetëm në një makineri, madje edhe në një lojë me bashkim figurash, dikush duhet t'i vendosë saktë pjesët, në mënyrë që të përfitohet figura e dhënë. Hunda juaj që funksionon si një kondicioner ajri, është e përbërë gjithashtu nga shumë pjesë përbërëse dhe përmban një sistem shumë më të përkryer se çdo




Sistemi që punon në trupin tuaj kur merrni frymë ka një ndërtim shumë më të përsosur se çdo kondicioner, që ftoh ajrin për ju në verë.



kondicioner ajri në botë. Ashtu si një kondicioner ajri nuk mund të prodhohet rastësisht, aq më pak mundet një hundë, e cila është akoma më e ndërlikuar. Ky fakt na shpalos që ky organ i cili njihet si “sistemi më i mirë i kondicionimit të ajrit në botë”, është krijuar nga Zoti ynë. Allahu e thekson cilësinë e Tij si Krijues në ajetin e mëposhtëm:

Ai është Allahu- Krijuesi, Shpikësi, Formësuesi. Të Tij janë emrat më të bukur. Atë e madhëron çdo gjë në qiej e në tokë.

Ai është Ngadhënyyesi, i Urti. (Sure El Hashr: 24)



Qimëzat e laringut lundrojnë pa bërë asnjë gabim

Ajri që pastrohet në hundë vazhdon rrugën më tej përgjatë rrugëve të frymëmarrjes. Zona tjetër pas hundës që shërben për thithjen e ajrit është laringu. Në këtë ajër ka ende materiale të huaja të tilla si pluhuri, që janë të dëmshme për shëndetin. Si rrjedhim, është e nevojshme që, ajri i thithur të kalojë në një kontroll tjetër sigurie para se të arrijë në mushkëri. Ky kontroll sigurie mundësohet nga shtresa e rrëshqitshme që shtrihet përgjatë sipërfaqes së rrugëve të frymëmarrjes. Kjo membranë quhet shtresa e mukozës.



Në ajrin që ne thithim, ndodhen shumë mikrobe dhe substanca të dëmshme. Ne jemi të mbrojtur nga shumë prej tyre në sajë të qimëzave që shtrihen përgjatë traktit të frymëmarrjes. Ato nuk mund të na dëmtojnë, falë këtij sistemi që Allahu ka krijuar për ne.

Mukoza e cila e formon këtë shtresë, kap grimcat e vogla të tilla si pluhuri që ne kemi thithur së bashku me ajrin dhe i pengon ato të hyjnë në mushkëri. Përveç kësaj, materialet e huaja të grumbulluara duhet të eliminohen nga trupi. Në këtë pikë, hyn në lojë një mekanizëm tjetër sigurie. Ky mekanizëm përbëhet nga struktura të vogla si qime që quhen cilie, të cilat janë vendosur poshtë shtresës së mukozës. Këto qime të vogla valëzojnë ritmikisht në drejtimin lart drejt gojës. Kjo mund të krahasohet me kallinj të grurit të cilat valëzojnë nga era të gjitha në të njëjtin drejtim. Në sajë të lëvizjeve të këtyre qerpikëve, mukoza e cila mban materialet e huaja, transportohet lart përgjatë laringut.





Qimëzat e laringut, siç mund të shikohet në figurën më lart, kapin materialet e huaja dhe i pengojnë ato të hyjnë në rrugët e frymëmarrjes.

Pasi materiali i huaj vjen lart në fyt, ju ndjeni natyrshëm nevojën ta gëlltisni atë. Kështu që i gjithë materiali i huaj që mund të dëmtonte shëndetin tuaj kalon në stomakun tuaj, ku ai shpërbëhet dhe shkatërrohet nga lëngu gastrik.

Ciljet e vendosur në laring nuk kanë sy që të shikojnë, as mend që të logjikojnë. Pavarësisht nga kjo, ato mund ta përcaktojnë vendndodhjen e gurmazit, i cili është shumë larg në krahasim me përmasat e tyre. Veç kësaj, duke qenë në dijeni të dëmit të mundshëm që mund të shkaktojë materiali i huaj, ato nuk e lejojnë këtë të fundit të depërtojë në trup. Pavarësisht nga kërkimet shkencore të kryera për vite më radhë, mekanizmi i këtyre qimeve nuk është zbuluar

Pse është kaq i rëndësishëm ajri që thithim? Pse vdesin njerëzit që nuk janë në gjendje të marrin frymë për më shumë se një kohë e caktuar? Le ti përgjigjemi këtyre pyetjeve si më poshtë: Oksigjeni është ushqimi kryesor i qelizave të trupit. Qelizat e muskujve në duart tuaja ushqehen vazhdimisht me oksigjen në mënyrë që të mbajnë këtë libër. Dhe për këtë, ju duhet të merrni frymë.



plotësisht. Por, kini parasysh, që këto qime, sistemi i të cilave nuk është zbuluar akoma nga qeniet njerëzore, kanë punuar në mënyrë të përkryer, si të gjitha pjesët e tjera të trupit, që kur njeriu i parë u shfaq në sipërfaqen e tokës.

Ndonjëherë, një cope ushqimi ose pijeje, rrëshqet aksidentalisht në gypin e frymëmarrjes, gjë që ngacmon refleksin e kollës. Kolla formon një shpërthim ajri të ngjeshur, përmes të cilës, copëza që rrëshqiti në gypin e frymëmarrjes përzihet jashtë me shpejtësi deri 960 km në orë. Merrni në konsideratë që shpejtësia më e madhe e makinave të garës është 250-260 km në orë, për të kuptuar më mirë se sa i mrekullueshëm është mekanizmi mbrojtës i trupit.



AJRI I THITHUR TASHMË ËSHTË NË MUSHKËRI...

Ajri që vjen në mushkëri është gati për t'u përdorur pasi ai është pastruar dhe lagështia e tij është rregulluar përgjatë laringut. Me anë të qarkullimit të gjakut, ai transportohet nga mushkëritë në të gjitha qelizat e trupit në mënyrë që t'i ushqejë ato. Ndërkohë, ai merr nga qelizat dioksidin e karbonit, i cili është një material i panevojshëm. Kur ne e nxjerrim frymën, ne nxjerrim jashtë dioksidin e karbonit që është mbledhur nga qelizat.

Frymëmarrja juve mund t'ju duket një varg veprimesh të thjeshta, por, me anë të saj ndodh një shkëmbim mjaft i rëndësishëm i oksigjenit dhe dioksidit e karbonit thellë në çdo qelizë të trupit tuaj. Të gjitha këto janë dhurata të Allahut ndaj nesh; Ai i krijoi të gjitha ato dhe i vendosi në shërbimin tonë. Mendoni çfarë mund të ndodhte, nëse thjesht vetëm frymëmarrja, të lihej nën kontrollin tonë të ndërgjegjshëm. Ne nuk do të ishim në gjendje ta kryenim pa gabime. Ne do të lodheshim dhe do të hiqnim dorë nga një detyrë e tillë vetëm pas pak kohe. Zoti ynë e di që ne nuk mund ta kryejmë vetë këtë detyrë. Kështu që, Ai ka krijuar sistemin e



frymëmarrjes i cili punon në mënyrë të përkryer, njëlloj si të gjithë sistemet e tjerë në trupin tonë, ashtu siç e kemi shpjeguar gjatë gjithë këtij libri. Kjo është një nga dhuratat që Allahu na ka dhënë në këtë botë. Siç thuhet në një ajet:

Dhe Ai ju dha çdo gjë që kërkuat (që e kërkoj nevoja juaj), dhe në qoftë se përpiqeni t'i numëroni të mirat e Allahut ju nuk do të arrinit kurrë t'i numëronit ato. Vërtetë njeriu është i padrejtë dhe shumë përbuzës. (Sure Ibrahim: 34)

Okgjeni thithet nga trupi ynë përmes këtyre qeskave të ajrit, të quajtura alveola, të cilat gjenden në mushkëri.

Në këtë pikturë mund të shihni disa nga përbërësit e aparatit të frymëmarrjes.



PËRFUNDIM


N

ë këtë libër ne dhamë disa shembuj dhe shpjeguar që në trupin tonë ndodhin shumë ndryshime të pandërprera për të cilat ne jemi plotësisht të pavetëdijshëm. Çdo organ dhe çdo qelizë në trupin tonë punon me një shpejtësi të pabesueshme dhe në të njëjtën kohë funksionon në mënyrë të përsosur. Të gjithë organet i kryejnë detyrat që i janë caktuar në harmoni. Gjaku u dërgon vazhdimisht ushqim qelizave, për të cilin ato kanë nevojë që të jetojnë. Stomaku dhe zorrët e copëzojnë këtë ushqim në grimca dhe e bëjnë atë të përshtatshëm për t'u përdorur nga qelizat. Qelizat nervore u dërgojnë stimuj gjithë pjesëve të trupit; truri i vlerëson këto stimuj, dhe, si rezultat, ne arrijmë të shikojmë, të dëgjojmë, të shijojmë dhe të perceptojmë me të gjithë shqisat e tjera.



Kur njëra nga këto detyra vonohet ose nuk kryhet, rregulli normal i funksioneve tona trupore prishet. Nëse qelizat nervore dëmtohen, gjymtyrët tona nuk funksionojnë, nëse dëmtohen qelizat e stomakut ne nuk mund ta tresim ushqimin që hamë; nëse na dëmtohen qelizat e gjuhës ne nuk mund të shijojmë dot tortën me çokollatë, portokajtë, bananet apo ëmbëlsirat. Megjithatë, përveç se kur jemi të sëmurë, asnjëra nga ato që thamë më sipër, nuk ndodh. Çdo organ i trupit tuaj kryen pandërprerë detyrat e veta normale ndërsa ju jetoni të qetë jetën tuaj. Përsosmëria me të cilën jeni bekuar në çdo moment të jetës tuaj patjetër që e ka një arsye. Asgjë nuk mund të lindë vetvetiu dhe të ketë një ndërtim kaq të plotë dhe pa të meta.






Televizori, frigoriferi, kompjuteri, stilolapsat që përdorni kur shkruani, shkurt, çdo gjë e ka një projektues dhe prodhues. Një makinë apo një aeroplan nuk mund të shpiket vetvetiu. Duke qenë kështu, është thjesht e pamundur për një tërësi kaq të përsosur sistemesh si trupi i njeriut të vijë në jetë rastësisht.

Ju, me siguri, habiteni se si ka mundësi që, disa njerëz mendojnë që trupi i tyre funksionon si rezultat thjesht i rastësisë. Ky, me të vërtetë, është pohimi më i paarsyeshëm që mund të parashtrohet ndonjëherë. Rregulli i mrekullueshëm në trupin e njeriut nuk mund të ketë ardhur në ekzistencë rastësisht. Ky rregull i mrekullueshëm provon që ai është projektuar nga një Qenie me inteligjencë dhe dituri të pakufishme. Ai është vepër e një Krijuesi të Lartë, Zotit tonë.

Allahu na tregon në Kur'an se, Ai është i Gjithmëshirshëm ndaj robërve të Tij. Ajo që na takon të bëjmë, është që t'i nënshtrohemi Atij, t'i bindemi plotësisht urdhrave të Tij dhe ta falënderojmë Atë për të gjitha bukuritë që na ka dhënë. Në një ajet Kur'anor, Allahu na drejtohet si më poshtë:

Ky është Allahu, Zoti juaj. Nuk ka zot tjetër përveç Tij, Krijuesi i çdo gjëje, pra adhurojeni Atë. Ai është mbikëqyrës ndaj çdo gjëje. (Sure El-En'am: 102)





**Ëngjëjt thanë: "Lavdia të qoftë
Ty Zoti ynë. Ne nuk kemi dije tjetër
përveç asaj që na dhurove.
Ti je i Gjithëdijshmi, i Urti."
(Sure Bekare: 32)**



Gjithashtu nga Harun Jahja

